

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

**GJYKIMET E KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË:
NJË VLERËSIM PAS DHJETË VITEVE
1999 – 2009**

Maj 2010

TABELA E PËRMBAJTJEVE

FJALORTH.....	3
PËRMbledhje EKZEKUTIVE	5
I. HYRJE.....	7
Definicioni i krimit të luftës.....	9
Ligji i Aplikueshëm	10
II. SHQYRTIM PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS NGA SISTEMI LIGJOR PREJ 1999-2009	10
Zhvillimi i Sistemit Gjyqësor në Kosovë prej vitit 1999.....	10
Avokatët Mbrojtës në Rastet e Krimeve të Luftës.....	12
Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë	13
Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë.....	14
Vonesat	16
Vonesat në fazën e hetimit policor.....	16
Vonesat në fazën e hetimit të prokurorisë.....	17
Vonesat në fazën e gjykimit.....	18
Vonesat në fazën e ankesës.....	19
Mungesa e vazhdimësisë në personelin gjyqësor	21
III. GJETJET DHE SHQETËSIMET	22
Aktgjykimet përfundimtare.....	23
Ekspertiza në procedura gjyqësore që përfshijnë krime të luftës	24
Ndërtimi i kapaciteteve për gjyqtarë dhe prokurorë vendor	26
Perceptimi i anshmërisë	26
Kërcënimet ndaj gjyqësorit	27
Mbrojtja e dëshmitarëve	28
Oda e veçantë për rastet e krimeve të luftës	29
Menaxhimi me barrën e lëndëve të krimeve të luftës	30
Informimi i publikut lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.....	30
Nevojat tjera.....	31
IV. KONKLuzion.....	31
V. REKOMANDIME	32

FJALORTH

ABA/CEELI (Orig.)	Iniciativa Ligjore e Shoqatës Amerikane të Avokatëve për Evropën Qendrore dhe Lindore
CIVPOL (Orig.)	Policia Civile (UNMIK)
CDRC (Orig.)	Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike
DAGj	Departamenti i Administratës Gjyqësore
DD	Departamenti i Drejtësisë (UNMIK)
EULEX (Orig.)	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
GjEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
GJKLEK	Gjykata për Krime të Luftës dhe Etnike në Kosovë
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KFOR (Orig.)	Forca e Kosovës (NATO)
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
LP i RSFJ-së	Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë
LPP i RFJ-së	Ligji i Procedurës Penale i Republikës Federative të Jugosllavisë
NATO (Orig.)	Organizata e Paktit Veri-atlantik
NJMD	Njësi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve
ODIHR (Orig.)	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PS	Prokuroria Speciale
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
SEGJ	Sistemi Emergjent Gjyqësor
SMSJ	Misioni i OSBE-së në Kosovë, Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
UNMIK (Orig.)	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Krimet e luftës, nga vet natyra e tyre, është vështirë të trajtohen në cilëndo shoqëri në një mjedis pas konfliktit. Individët sapo kanë dal nga një periudhë e shënuar me dhunë gjatë së cilës shumë janë vrarë, përfshirë edhe anëtarë të familjes dhe shokë; disa kanë mbetur të lënduar, fizikisht dhe/ose nga ana psikologjike; shtëpitë dhe pronat janë shkatërruar; shërbimet themelore janë ndërprerë; ushqimi është i pakët; dhe shumë janë të zemëruar dhe të frikësuar. Në mes të gjithë kësaj qëndron problemi i zgjidhjes së asaj se cilat nga veprat që kanë ndodhur gjatë konfliktit ishin “jologjore” dhe cilat ishin pjesët “ligjore” të konfliktit të armatosur.

Qëllimi i këtij raporti është që të shqyrtohet dhe vlerësohet se si janë trajtuar çështjet e krimeve të luftës nga sistemi i drejtësisë penale në Kosovë gjatë dhjetë viteve të fundit, pas konfliktit të majit 1998- qershor 1999.¹ Veç kësaj, raporti vlerëson se cilat janë nevojat që ende ekzistojnë dhe rekomandon mënyra se si sistemi mund të gjykojë në mënyrë më efektive rastet e krimeve të luftës. Ky raport mbulon periudhën prej qershorit të vitit 1999 deri në dhjetor të vitit 2009 në Kosovë. Gjatë kësaj kohe një numër akterësh kanë marr pjesë në sistemin e drejtësisë penale, që është një mjedis i veçantë dhe sfidues për këto çështje të adresohen. Prandaj, në mënyrë që të vlerësohet drejtë situata se si sistemi ka trajtuar rastet e krimeve të luftës, shumë aspekte të sistemit duhet të merren parasysh dhe të shqyrtohen. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka qenë përgjegjës për administrimin e drejtësisë për pjesën më të madhe të kësaj kohe.² Në qershor të vitit 2008, Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve ka bërë të ditur ri-konfigurimin e strukturës dhe profilin e pranisë civile ndërkombëtare në Kosovë.³ Si i tillë, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) do të “merr përgjegjësitë në fushën e policisë, drejtësisë dhe doganave, nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara të kryesuar nga [...] [Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm] dhe në pajtim me rezolutën 1244 (1999).”⁴ Përgjegjësia i është kaluar gradualisht institucioneve vendore gjyqësore gjatë kësaj periudhe, megjithëse jo edhe në çështjet e krimeve të luftës.

¹ Një analizë e mëparshme e OSBE-së mbi krimet e luftës ka shqyrtuar veprat që pandehen ose janë dëshmuar të jenë kryer gjatë kësaj periudhe kohore. Ndjekja penale e këtyre veprave filloi me 5 nëntor 1999, kur u ngrit aktakuza e parë. Shih faqen 9, Raporti i OSBE-së, *Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë, Shqyrtim*. E qasur me 23 prill 2010, http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf.

² Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, S/RES/1244, 10 qershor 1999, paragrafi 10 “[a]utorizon Sekretarin e Përgjithshëm, me ndihmën e organizatave përkatëse ndërkombëtare, të vendosë prezencën civile ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që të ofrojë një administrim të përkohshëm për Kosovë [...]” E qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.un.org/Docs/scres/1999/sc99.htm> e më pas në Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit (1999).

³ Shih *Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S.2008/354, 12 qershor 2008, paragrafët 14-16; E qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/sgrep08.htm> e më pas në raportin i 12 qershorit 2008.

⁴ Shih *Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/2008/692, 24 nëntor 2008, paragrafi 23. E qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/sgrep08> e më pas në raportin i 24 nëntorit 2008. Sekretari i Përgjithshëm më tej deklaroi në këtë raport në paragrafin 24 se: “Sipas një marrëveshjeje operationale mbi qasjen dhe zbulimin e materialeve lidhur me hetime të caktuara penale dhe procedura përkatëse gjyqësore, Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut ka përgatitur udhëzues për

Deri më sot, disa individë janë gjykuar, ose ende ndodhen në gjykim, pranë Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë (GJNPJ), për veprat të cilat rrjedhën, së paku pjesërisht, nga konflikti i armatosur në Kosovë. Ka pasur 1,187 vepra të dyshuara të krimeve të luftës të dala nga konflikti, të cilat i identifikoi UNMIK-u dhe ia kaloi EULEX-it, dhe 50 raste shtesë të cilat ju kishin transferuar pasi që ishin referuar për aktakuzë.⁵ Duhet të nënvizohet se Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (OSBE) është përballur me vështirësi në mbledhjen e statistikave të besueshme lidhur me rastet e krimeve të luftës për këtë kornizë kohore dhjetë-vjeçare për shkak të numrit të autoriteteve dhe institucioneve të ndryshme të angazhuara në këtë fushë, dhe për shkak të faktit se nuk ka një bazë qendrore të dhënash për informacion të tillë.

Gjetjet dhe shqetësimet në këtë raport mund të përmbliidhen siç vijon: ka pasur një dështim të sistemit për të gjykuar krimet e luftës. Që prej fillimit, vënia në prioritet e rasteve të krimeve të luftës shpesh ka qenë në fokus të diskursit publik, por ishte prioritet vetëm në emër. Kurrë nuk janë caktuar resurse të mjaftueshme për këtë qëllim. Nuk janë marr as vendime që të vendosen krimet e luftës mbi prioritetet tjera. Përderisa është më se e vërtetë se ka pasur shumë nevoja urgjente në Kosovë që prej vitit 1999 deri më tani, faktet flasin që adresimi i krimeve të luftës, kurrë nuk ka qenë më i rëndësishmi ndërmjet tyre.

Sa më të vjetra bëhen rastet e krimeve të luftës, veç sa bëhen më të vështira për tu gjykuar. Viktimat, dëshmitarët dhe dëshmitë mund të bëhen më pak të qasshme me kalimin e kohës. Ngjashëm, sa më shumë zgjatet një rast, më pak hetues dhe prokurorë që fillimisht kanë punuar në rast ka gjasa të qëndrojnë në Kosovë për të asistuar në procedura.

Në rastet tjera, të akuzuarit kanë ikur nga juridiksioni dhe nuk ka shumë gjasa që ata të kthehen. Trajtimi më i shpejtuar i këtyre rasteve pas konfliktit ka mundur të ndihmojë që ky problem të parandalohet. Siç qëndron aktualisht, për shkak të kohës që ka kaluar dhe vëllimit të rasteve të mbetura, do të jetë tejet e vështirë që të sigurohet se të gjitha palët e përfshira do të kenë gjykim të drejtë në të gjitha rastet të mbetura. Veç kësaj, numri i madh i rasteve të kthyera dhe dënimeve të ndryshuara pasi që lëndët janë trajtuar nga akterë të njëpasnjëshëm, mund të vë në pikëpyetje parimin e aktgjykimeve përfundimtare apo *res juridicata*. Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm rajonal në gjetjen e vendndodhjes së dëshmitarëve dhe të akuzuarve për gjykim, gjithmonë ka qenë problematike.

Ka një numër rekomandimesh të cilat, po që se merren parasysh, do të mund të ndihmonin në përfundimin e rasteve të mbetura. Së pari, rasteve të mbetura të krimeve të luftës është dashur tu vihet prioriteti më i lartë nga ana e EULEX-it dhe sistemit gjyqësor në Kosovë. Këto raste veç sa do të bëhen më të vështira të gjykohen aq sa

të ja lehtësuar prokurorëve të EULEX-it qasjen në shkresat e lëndëve të trajtuara nga prokurorët ndërkombëtar dhe prokurorët special. Qasja në materiale policore lidhur me hetime të caktuara penale i ofrohet komponentës së policisë së EULEX-it mbi baza të një marrëveshjeje të ngjashme mbi të cilën është vendosur në shtator.”

⁵ *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/2009/149, 17 mars 2009, paragrafi 19. E qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/sgrep09.htm> e më pas në raportin i 17 marsit 2009.

më shumë kohë kalon nga ngjarjet në fjalë. Andaj duhen të caktohen resurse adekuate për këtë prioritet. Pa to, vënia në prioritet e rasteve të krimeve të luftës do të mbetet realitet vetëm në letër. Së dyti, përkrahje adekuate dhe resurse si nga buxheti i Kosovës ashtu edhe nga donatorët ndërkombëtar janë të nevojshme për mbrojtje kuptimplotë të dëshmitarëve. Etnitet e përfshira, duhet të jenë të gatshme të pranojnë zhvendosjen e dëshmitarëve që janë në rrezik. Gjyqtarët dhe prokurorët vendor duhet të vazhdojnë të marrin pjesë në këto raste. Si të tillë, atyre ju duhet gjithashtu edhe mbrojtje. Së treti, gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës ende u mungon kompetenca e përgjithshme në këtë fushë të specializuar të ligjit. Andaj, trajnime dhe ndërtim kapacitetesh duhet t'u ofrohen individëve që trajtojnë këto raste. Së fundmi, formimi i një ode të specializuar ose departamenti për krime serioze siç janë krimet e luftës duhet të mbetet në agjendë përmes kalimit të projekt-ligjit mbi gjykatat, që përfshin dispozitat lidhur me këtë çështje.

Rastet e krimeve të luftës është vështirë që të hetohen, ndiqen penalisht, mbrohen dhe të gjykohen. Shqetësimi lidhur me shtrirjen politike dhe të sigurisë së këtyre rasteve është po ashtu shumë domethënëse. Përderisa vlerësohet se nuk do të jetë lehtë që të zbatohen këto rekomandime, vendimet duhet të merren që këto raste të hetohen dhe gjykohen përfundimisht dhe plotësisht, për një konkluzion të drejtë. Të gjitha komunitetet në Kosovë kanë qenë të ndikuara dhe askush nuk do të jetë në gjendje që plotësisht ta mbyll këtë kapitull të vështirë të jetës së tyre dhe të ecin më tutje derisa rastet e mbetura të krimeve të luftës të mos trajtohen si duhet nga sistemi gjyqësor. Ky është një ndër testet më kritike dhe ekstreme me të cilin do të ballafaqohet cilido sistem ligjor. Është bërë akoma më i vështirë për shkak të llojllojshmërisë ligjore dhe institucionale në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, mos-adresimi i plotë dhe përfundimtar i këtyre çështjeve do të reflektojë dobësi në sistemin gjyqësor të Kosovës. Po të mos bëhet kjo, do të jetë një shkelje e madhe e besimit që i është dhënë sistemit gjyqësor dhe do të ndikojë negativisht si në të kaluarën ashtu edhe në të ardhmen e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

I. HYRJE

Kur një individ është viktimë e një veprë penale, ai ose ajo ndjehet i/e cenuar dhe shikon nga sistemi i drejtësisë penale për të sjellë drejtësinë në vend që në njëfarë mënyre të kthejë atë që është humbur. Kur krimet ndodhin në një shkallë të madhe gjatë një konflikti të armatosur, shoqëria ndjehet e viktimizuar dhe e cenuar, në mënyrë individuale ose kolektive, dhe kërkon të njëjtën ndjenjë të restaurimit të bilancit të drejtësisë. Shoqëria ka nevojë të dijë që kryesit e veprave nuk do të kalojnë pa u ndëshkuar. Ky është një hap i domosdoshëm të sjell restaurim brenda shoqërisë, para se pajtimi të mundë të fillojë në të vërtetë.

Trajtimi i rasteve të krimeve të luftës është një ndër testet më kritike si për besueshmërinë ashtu edhe për kompetencën e sistemit të drejtësisë. Kjo është pjesërisht për shkak të faktit se krimet e luftës, nga vet natyra e tyre, janë të ndërlikuara dhe të vështira për tu adresuar plotësisht. Shumë faktorë kontribuojnë në këtë: hetimet e ndara të kryera nga organizata të shumta, pyetjet lidhur me atë se çfarë ligje janë të aplikueshme, kryqëzimet ndërmjet ligjit ndërkombëtar dhe atij vendor, marrja parasysh e normave vendore dhe standardeve ndërkombëtare ligjore, nevoja për gjyqtarë kompetent dhe të paanshëm, mbrojtja dhe përkrahja për viktima dhe

dëshmitarë, mbrojta për anëtarët e gjyqësorit, vështirësitë rreth vërtetimit të aktakuzave të ndërlikuara, dhe vështirësitë e lidhjes së akterëve me ata me përgjegjësi komanduese. Veç kësaj, ngjarjet në fjalë kanë ndodhur gjatë një konflikti të armatosur që ka shkaktuar trazira dhe trauma të panjehsueshme.

Konflikti i armatosur në Kosovë filloi në vitin 1998 dhe zgjati deri në qershor të vitit 1999. Marrëveshja Teknike Ushtarake ndërmjet Forcave Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë u nënshkrua me 9 qershor 1999. Më pas shumë raste të dyshuara të krimeve të luftës ishin hetuar, më së shumti nga hetuesit ndërkombëtar nga GJNPJ, Policia Civile e UNMIK-ut (CIVPOL), dhe së fundmi nga hetuesit e EULEX-it.⁶ Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) sapo ishte duke u krijuar nga fundi i vitit 1999 dhe nuk mori rol udhëheqës në hetimin e krimeve të luftës.⁷ Për aq sa është në dijeni OSBE-ja, nga fundi i vitit 2009, 37 persona ishin gjykuar për raste të pandehura të krimeve të luftës në Kosovë.⁸

Është një perceptim i përgjithshëm brenda shoqërisë në Kosovë, se shumica e personave të dyshuar për kryerje të krimeve të luftës gjatë konfliktit, nuk janë mbajtur përgjegjës. Ndjenja se individët kalojnë pa u ndëshkuar është shqetësuese për shumë arsye, jo më e vogla prej të cilave është se si kjo ndikon në besimin e popullatës për vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë. Nëse institucionet gjyqësore dhe ato të policisë nuk mund ti adresojnë këto raste tejet të rënda, atëherë kompetenca dhe besueshmëria e tërë sistemit vihet në pyetje.

Nga gushti 2009 “EULEX [...] po hetonte 50 raste aktive. Një numër tjetër prej 1,009 rasteve ishte jo-aktiv. Nga këto, 158 raste ishin hedhur poshtë për shkaqe të ndryshme siç është mungesa e dëshmive. Palët e dëmtuara[...] [do duhej] të informohen për mbyllje të rasteve brenda kohës së duhur. Në përgjithësi, 851 nga rastet jo-aktive[...] [do duhet] të hetohen.”⁹ Qëkur EULEX-i filloi operimin me 9 dhjetor 2008,¹⁰ katër raste të krimeve të luftës janë gjykuar deri në fund të vitit 2009.¹¹

Ky është një shqyrtim dhe vlerësim se si sistemi i drejtësisë, si tërësi, ka trajtuar krimet e luftës që rrjedhën nga konflikti në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.

⁶ OSBE nuk ka qenë në gjendje të identifikojë se sa incidente saktësisht ishin hetuar në përgjithësi.

⁷ Shkolla Policore e Kosovës filloi klasën e vet të parë në shtator të vitit 1999 dhe diplomoi gjeneratën e parë të kadetëve në tetor të vitit 1999; *Historiku i OSBE-së: Edukimi dhe Zhvillimi i Policisë* (mars 2005). E qasur me 23 prill 2010 në: http://www.osce.org/publications/mik/2005/04/14272_323_sq.pdf. Si shtyllë për ndërtim institucionesh e UNMIK-ut, OSBE-ja kishte për detyrë të themelojë shkollën policore në Vushtri/Vučitrn, vendndodhja e ish-akademisë policore, dhe të ofrojë trajnim fillestar për anëtarët e ardhshëm të Shërbimit të ri Policor të Kosovës. Nga korriku 1999, OSBE-ja kishte “identifikuar vendin për themelimin e akademisë trajnuese për policinë dhe se përgatitjet për të filluar trajnimin e kadetëve të policisë [...] [ishin] në rrugë e sipër.” Shih paragrafët 33 dhe 79 të *Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/1999/779, 12 korrik 1999, e qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/reports/1999/sgrep99.htm> e më pas në raportin e 12 korrikut 1999.

⁸ Shifrat e mbledhura nga burime në UNMIK dhe EULEX. Ky nuk është një numër total zyrtar.

⁹ *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/2009/497, 30 shtator 2009. Shtojca I, pjesa 2. “Policia”. E qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/sgrep09.htm> e më pas në raportin e 30 shtatorit 2009.

¹⁰ Të dhënat nga konferenca për shtyp e Komponentës së Drejtësisë pranë EULEX-it, 3 qershor 2009.

¹¹ Sipas informacionit të marrë nga monitoruesit e OSBE-së prej shkresave publike të lëndëve.

Fushëveprimi i këtij raporti mbulon periudhën që prej vendosjes së UNMIK-ut në qershor të vitit 1999 deri në fund të vitit 2009. Shikon në atë se çfarë sfida kanë dal përpara, çfarë gabime janë bërë, çfarë nevoja ende ekzistojnë në sektorin gjyqësor dhe ofron rekomandime se si të përmirësohet sistemi, në mënyrë që të arrihet qëllimi të silltet një rezultat i drejtë në rastet e mbetura të krimeve të luftës.

Ky raport nuk ofron analizë të plotë të të gjitha rasteve të krimeve të luftës veç e veç, që janë paraqitur në gjykata. Në vend të kësaj, bazohet në mësimet e nxjerra nga përvoja e sistemit gjyqësor në Kosovë që prej vitit 1999, për të ofruar një pasqyrë të aspekteve ligjore, strukturore dhe organizative të sistemit gjyqësor në lidhje me krimet e luftës dhe të identifikojë fushat specifike për përmirësim në mënyrë që të lehtësohet procedimi efikas i çështjeve të mbetura të krimeve të luftës, ose së paku një masë e konsiderueshme e tyre.

OSBE ka monitoruar rastet e krimeve të luftës të dala nga konflikti që prej kohës kur gjykatat kanë filluar ti shqyrtojnë ato në vitin 1999. Që prej atëherë, OSBE ka publikuar në mënyrë periodike gjetjet e veta në raporte të ndryshme publike dhe gjysmë-publike.¹² Gjatë dekadës së fundit OSBE ka identifikuar një numër çështjesh problematike që ndërlidhen me trajtimin e këtyre rasteve dhe i ka nënvizuar ato në raporte të ndryshme. Problemet dhe rekomandimet gjegjëse, të cilat janë ende relevante, janë të përfshira në këtë raport, pasi që OSBE konsideron se ato ende duhet të adresohen në mënyrë që këto çështje kritike të trajtohen më mirë.

Definicioni i krimit të luftës

Aktet e paligjshme të cilat ndodhin gjatë një konflikti të armatosur janë definuar në mënyrë të ndryshme në juridiksione të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare. Megjithatë, akte të tilla në thelb përbëjnë shkelje të Konventave të Gjenevës, protokolleve të tyre, ose të ligjeve dhe zakoneve të luftës, lidhur me shkelje të ligjit ndërkombëtar humanitar, për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Në Ligjin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP i RFJ-së)¹³ krimet e tilla u përcaktuan në bazë të Konventave të Gjenevës, pasi që Jugosllavia ishte palë nënshkruese.¹⁴ Për qëllime të këtij raporti termi "krimet të luftës" është përdorur për të përfshirë çfarëdo dhe të gjitha shkeljet e tilla të së drejtës ndërkombëtare dhe vendore të cilat mund të ketë ndodhur gjatë, dhe që lidhen me konfliktin në Kosovë në vitet 1998-1999. Është për lehtësi të referimit që ky term është përdorur në këtë kuptim të përgjithshëm, dhe jo në përkufizimin e tij më të limituar të një klase të krimit në këtë fushë të ligjit.

¹² Shih raportin e OSBE-së *Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë; Shqyrtim*. E qasur me 23 prill 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf.

¹³ LP i RSFJ-së, Neni 142.

¹⁴ Shih Ligjin mbi Ratifikimin e Protokolleve të Gjenevës, të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 'Medunarodni Ugovori' në 1083, 26 dhjetor 1978. Ky ligj ka inkomporuar Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre në ligjin vendor të RSFJ-së.

Ligji i Aplikueshëm

Ligji i aplikueshëm në Kosovë në përgjithësi ka qenë një çështje e ndërlikuar gjatë viteve.¹⁵ Në vijim është një pasqyrë shumë e shkurtër e ligjit pasi që ndërlidhet me krimet e luftës të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Në vitin e parë të vet, UNMIK-u deklaroi se ligji në fuqi në Kosovë i 22 marsit 1989, ishte pikë fillestare për ligjin e aplikueshëm në Kosovë.¹⁶ Gjithashtu do të përfshijë Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe instrumentet ligjore subsidiare të lëshuara. Prandaj, ligji lidhur me krimet e luftës është një kombinim i të dyjave, të LP të RSFJ-së¹⁷ dhe Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), i miratuar në vitin 2003.¹⁸ Përcaktimi lidhur me atë se cili ligj aplikohet në cilën situatë në këtë rrjet të ligjeve ka qenë i vështirë njësoj si për gjyqtarët vendor ashtu edhe për ata ndërkombëtar.

Në këtë rrethanë është sfidë se si ligji ndërkombëtar mund të aplikohet në rastet e krimeve të luftës që gjykohen në Kosovë. Të drejtës zakonore ndërkombëtare i është dhënë peshë e ndryshme nga vendime të ndryshme të gjykatave të Kosovës.¹⁹

Gjykatat penale ndërkombëtare speciale të themeluara gjatë viteve kanë dhënë një jurisprudence të pasur në fushën e ligjit penal ndërkombëtar.²⁰ Kjo pasuri përvojash dhe zhvillimesh ligjore mund t'u ndihmojë gjykatave në Kosovë në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Megjithatë, për të qenë të dobishme, materialet përkatëse dhe regjistrat e këtyre gjykatave duhet të jenë plotësisht të përkthyer në gjuhët vendore në mënyrë që të kuptohen, dhe në raste kur është e përshtatshme, të zbatohen.

II. SHQYRTIM PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS NGA SISTEMI LIGJOR PREJ 1999-2009

Zhvillimi i Sistemit Gjyqësor në Kosovë prej vitit 1999

¹⁵ Për një përshkrim më të detajuar shih raportin e OSBE-së, *Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë; Shqyrtim*. (shtator 2002) Pjesa III, faqet 29-33. E qasur me 28 prill 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf.

¹⁶ "Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj." Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, 12 dhjetor 1999, Neni 1.2. e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, 27 tetor 2000, dhe e vazhduar çdo vit.

¹⁷ Nuk ka pasur krime kundër njerëzimit të përfshira në Konventat e Gjenevës. Andaj, krimet kundër njerëzimit nuk kanë qenë të përfshira në ligjin e SFRJ-së, të aplikueshëm në Kosovë gjatë kohës së konfliktit.

¹⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), 6 korrik 2003 me ndryshimet pasuese. KPPK është i zbatueshëm, edhe pse është miratuar pas ngjarjeve të konfliktit, aty ku dispozitat e tij janë më të favorshme për të pandehurin, siç mund të jetë në dënimin e mundshëm.

¹⁹ Për më shumë lidhur me këtë çështje shih *Prokurori Publik kundër Latif Gashi, Rustem Mustafa, Naim Kadriu dhe Nazif Mehmetil*, gjykata e qarkut në Prishtinë, 16 korrik 2003.

²⁰ Raporti mbi *Përkrahja e Procesit në Tranzicion: Mësimet e Nxjerra dhe Praktikrat më të Mira në Bartjen e Njohurive, Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR)*, shtator 2009.

Në mënyrë që të vlerësohet se si rastet e krimeve të luftës janë trajtuar në Kosovë, duhet të merret parasysh zhvillimi i vet sistemit gjyqësor gjatë këtij dhjetëvjeçari të fundit. Përshkrimi i shkurtër që vijon, tregon kontekstin brenda të cilit janë trajtuar rastet e krimeve të luftës deri më tani në Kosovë.²¹

Policia dhe drejtësia kanë qenë komponentët kryesor të UNMIK-ut kur u themelua nga Kombet e Bashkuara (KB) në vitin 1999. Menjëherë pas konfliktit, nuk ka pasur autoritete zyrtare që operonin në Kosovë përpos NATO-s (KFOR), kështu që Policia Civile e UNMIK-ut (CIVPOL) ishte themeluar shpejtë për të plotësuar nevojën për polici civile. CIVPOL-i përbëhej nga vende të ndryshme anëtare të KB-ve. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) filloi operimet e veta në vitin 1999.²² Megjithatë, zyrtarët e SHPK-së nuk ishin të përfshirë në hetimin e rasteve të krimeve të luftës. Sistemi Emergjent Gjyqësor (SEGJ) filloi punën nga fundi i vitit 1999 dhe vazhdoi gjatë vitit 2000. SEGJ përbëhej nga gjyqtarë dhe prokurorë vendor, shumë prej të cilëve kishin punuar si të tillë nën sistemin e vjetër Jugosllav. Shumë nga ata nuk kishin punuar që nga fundi i viteve të 1980'ta si rezultat i ngjarjeve të cilat kanë ndodhur gjatë regjimit të Miloševićit.

Sa i përket rasteve të krimeve të luftës, ka pasur shqetësime lidhur me anshmëri etnike nga ana e gjyqësisë dhe prokurorisë vendore gjatë fazës së SEGJ.²³ Veç kësaj, si përgjigje ndaj trazirave publike dhe dhunës në Mitrovicë/Mitrovica në shkurt 2000, PSSP-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6, që rregullonte caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në Mitrovicë/Mitrovica.²⁴ Me 29 maj 2000, pas presionit nga grevistët e urisë në Mitrovicë/Mitrovica, shumica e të cilëve ishin të paraburgosur serb të Kosovës të hetuar ose në pritje të gjykimeve lidhur me krime të luftës, PSSP-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 me të cilën zgjeroi autoritetin për të caktuar gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar në tërë territorin e Kosovës.²⁵ Që nga ajo kohë, gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar kanë punuar në Kosovë në raste të ndryshme, përfshirë edhe në ato të krimeve të luftës.

Në ndërkohë, prej vitit 1999 filloi të merret parasysh themelimi i një Gjykate për Krime të Luftës dhe Etnike në Kosovë (GJKLEK), një gjykatë speciale në Kosovë për të adresuar rastet e krimeve të luftës dhe krimeve tjera serioze etnikisht të motivuara.²⁶ Shqetësimet e para ishin si nevoja për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë

²¹ Për një përshkrim më të detajuar shih raportin e OSBE-së, *Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë; Shqyrtim*. (shtator 2002). E qasur me 28 prill 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf.

²² Gjenerata e parë nga Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës diplomoi në nëntor 1999.

²³ Shih Shqyrtimi i parë i OSBE-së *mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë* (1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000), Rasti Momcilovic: Raport i Përkohshëm.

²⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 *mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtar dhe Prokurorëve Ndërkombëtar*, 15 shkurt 2000.

²⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6 *mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtar dhe Prokurorëve Ndërkombëtar*, 29 maj 2000.

²⁶ Në shtator 1999, Komiteti Teknik Këshillëdhënës mbi Shërbimin e Gjyqësisë dhe të Prokurorisë (KTK) u themelua për të këshilluar PSSP-në lidhur me strukturën dhe administrimin e shërbimit të gjyqësisë dhe prokurorisë në Kosovë. Shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/6 *mbi Rekomandimet për Strukturën dhe Administrimin e Shërbimit të Gjyqësisë dhe Prokurorisë*, të shpallur me 7 shtator 1999. Sipas kësaj rregulloreje, KTK ishte e përbërë nga “dhjetë anëtarë vendor dhe pesë ndërkombëtar, të zgjedhur për integritetin e tyre, aftësitë profesionale dhe përvojën.” Shih Nenin 2, *id.* Në raportin e vet përfundimtar të datës 13 dhjetor 1999, KTK rekomandoi mes tjerash, themelimin e një gjykate të jashtëzakonshme vendore me juridiksion për krime të luftës dhe shkelje

kompetent ashtu edhe anshmëria e mundshme etnike dhe nevoja për siguri për ata që do të ishin të përfshirë në raste të tilla. Mendohej se këto çështje mund të adresoheshin vetëm përmes një gjykate të specializuar. Megjithatë, buxheti rritej ashtu siç rriteshin planet. Kufizimet buxhetore dhe sukcesi²⁷ i gjykimit të rasteve të tilla në gjykatat vendore me ndihmën e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar kontribuoi në braktisjen e idesë për themelimin e GJKLEK-ut.²⁸ Edhe pse GJKLEK nuk është konkretizuar, nevojat për një gjykatë të tillë të specializuar ende ekzistojnë. Duhet të kuptohet se gjykimet e kësaj natyre vendosin një barrë të madhe mbi kapacitetin e gjykatave dhe kërkojnë resurse të veçanta logjistike dhe ekspertizë.

Avokatët Mbrojtës në Rastet e Krimeve të Luftës

Përderisa diskutoheshin meritat e GJKLEK-ut, u vë në pah se përkrahja do të nevojitej edhe për avokatët mbrojtës që do ti përfaqësonin të akuzuarit për krime lufte.²⁹ Në mënyrë për të pasur “barazi të armëve” të vërtetë, avokatët mbrojtës dhe prokuroria duhet të ishin në mënyrë të barabartë të pajisur mirë, në mënyrë që të ofrojnë përfaqësim kompetent për të akuzuarit.³⁰ Menjëherë pas konfliktit, avokatët vendor në Kosovë nuk kishin përvojë në mbrojtjen e rasteve të krimeve të luftës. Avokatët ndërkombëtar nuk lejoheshin të punojnë në Kosovë pa qenë banorë vendor dhe pa kaluar provimin e jurisprudencës.³¹

Dy hapa konkret institucional ishin ndërmarr për të ofruar mbështetje për ata avokatë mbrojtës që përfaqësojnë individët e akuzuar për krime lufte. Së pari, Oda e Avokatëve të Kosovës, shoqatë vendore e avokatëve, morri fonde dhe përkrahje nga donatorë të ndryshëm për të rritur aftësinë e vet që të ofrojë përkrahje dhe rrjete pune

tjera serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe krime serioze etnikisht të motivuara. Shih raportin e OSBE-së, Kosova, Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale, 1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000, faqe 75-76 për histori të mëtejme të idesë për GJKLEK.

²⁷ Sukcesi në atë që rastet e krimeve të luftës të mund të gjykohen në të vërtetë pranë një gjykate vendore pa shkelje serioze të sigurisë.

²⁸ OSBE më parë ka raportuar se “[t]hemelimi i GJKLEK-ut ishte vonuar në masë të madhe, ndërmjet tjerash, për shkak të, gjetjes së një hapësire të përshtatshme dhe rritjes së buxhetit.[...] Me 11 shtator 2000 DD-ja deklaroi se projekti lidhur me GJKLEK-un nuk do të vazhdohet dhe se përpjekjet do të koncentroheshin për të sjellë gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar në gjykata vendore.” Shih raportin e OSBE-së, Kosova, Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale, 1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000, faqe 76.

²⁹ U diskutuan dy modele të ndryshme, ajo e zyrës së Avokatit të Popullit e bashkangjitur GJKLEK-ut, dhe e një zyre mbështetëse për avokatët mbrojtës të caktuar nga gjykata. Kjo e fundit ishte zgjedhur, pjesërisht për shkak të faktit se sistemi i avokatëve mbrojtës të zgjedhur sipas detyrës zyrtare veçse përdorej, dhe pjesërisht për shkak të pyetjeve lidhur me financimin e zyrës së avokatit të popullit, dhe më në fund për shkak të dështimit të GJKLEK-ut.

³⁰ Neni. 6 (3) (c) KEDNJ, dhe Neni 12 (2) Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet dhe plotësimet pasuese (KPPPK). Shih po ashtu *Neumeister kundër Austrisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 22, i cili thotë se barazia e armëve është “e përfshirë në nocionin e gjykimit të drejtë (procès équitable) të përmendur në Nenin 6 (1).” Parimi i barazisë së armëve “kërkon që secilës palë ti jepet mundësi e arsyeshme për të prezantuar rastin e vet nën kushte që nuk do ta vendosnin atë në një mos-përparësi domethënëse vis-à-vis kundërshtarit të vet.” *Kress kundër Francës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 7 qershorit 2001, paragrafi 72.

³¹ Shih Nenet 35-36 të Ligji mbi Avokatinë dhe Ndihmë Tjetër Ligjore, Nr. 011-69/79 në Gazetën Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës Nr. 79/48 të 24 dhjetorit 1979. Shi po ashtu Nenin 6 të Ligjit për Avokatinë Nr. 03/L-117, Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr. 49, 20 nëntor 2008. Siç është dhënë në Nenin 39, paragrafin 1.7 të Ligjit për Avokatinë, Oda e Avokatëve të Kosovës lëshoi një “Rregullore mbi Licencimin e Avokatëve të Huaj” me 9 shtator 2009.

për avokatët vendor. Së dyti, Qendra Burimore për Mbrojtje Penale, (CDRC **Orig.**) u themelua në vitin 2001.³² CDRC-ja u ofronte ndihmë të drejtpërdrejtë në raste, avokatëve të cilët përfaqësonin të akuzuarit për krime lufte, përfshirë këtu sjelljen e avokatëve nga juridiksione tjera të cilët i ofruan avokatëve vendor ndihmë dhe ekspertizën e tyre, përderisa nuk përfaqësonin drejtpërdrejtë të pandehurit. Ata po ashtu ofruan trajnime për avokatë në këtë fushë të ligjit, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve.³³

Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë

GJNPJ-ja ka mandat për të ndjekur penalisht personat përgjegjës për shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991.³⁴ Me 29 shtator 1999 Kryeprokurorja e GJNPJ-së përshkroi rolin dhe përgjegjësitë e GJNPJ-së lidhur me ngjarjet në Kosovë.³⁵ Prokurorja po ashtu vëri në pah se resurset hetimore të gjykatës do të zbatohen mes tjerash edhe për “udhëheqës të lartë civil, policor dhe ushtarak, të tjerë të cilësdo palë në konflikt, të cilët mund të mbahen përgjegjës për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë.”³⁶

Që nga fundi i vitit 2009, në GJNPJ janë gjykuar ose janë ende në gjykim disa individë për vepra që kanë rrjedh, së paku pjesërisht nga ngjarjet në Kosovë: Milošević; Milutinović, Šainovic, Ojdanić, Pavković, Lazarević, Lukić (Milutinović *et alia*); Limaj, Musliu, Bala (Limaj *et alia*); Haradinaj, Balaj, Brahimaj (Haradinaj *et alia*). Rasti kundër Miloševićit ishte ndërprerë gjatë fazës së gjyimit për shkak të vdekjes së tij.³⁷ Në rastin Milutinović *et alia* pesë nga gjashtë të pandehurit ishin dënuar gjatë fazës së gjyimit; vetëm Milutinovići ishte shpallur i pafajshëm.³⁸ Rasti

³² OSBE dhe Shoqata e Avokatëve të Kosovës [Oda e Avokatëve të Kosovës] ishin anëtarët themeluesë të CDRC-së. Shih Statutin e Qendrës Burimore për Mbrojtje Penale (16 mars 2001), Neni 1, paragrafi 1.3.

³³ Pas shterjes së fondeve të veta, CDRC-ja i u bashkëngjiti Odës së Avokatëve, e cila vazhdoi herë pas herë të ofrojë për avokatët mbrojtës trajnime lidhur me krime të luftës, nganjëherë përmes organizatave tjera. CDRC-ja aktualisht funksionon me vetëm një punëtor. Shih raportin e OSBE/ODIHR *Përkrahja e Procesit në Tranzicion: Mësimet e Nxjerra dhe Praktikant më të Mira në Bartjen e Njohurive, Raport Përfundimtar*. Shtator 2009, faqe 86. E qasur me 29 prill 2009 në http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/report_supporting_transition_en.pdf. (në dispozicion edhe në gjuhën serbo-kroate/boshnjake në: http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/odihr_unicri_icty_2009report_bc_s.pdf).

³⁴ Shih paragrafin preambulë dhe Nenin 1 të Statutit të GJNPJ-së, i miratuar me 25 maj 1993 nga Rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e ndryshuar me 13 maj 1998 përmes Rezolutës 1166 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të KB-ve, e ndryshuar me 30 nëntor 2000 përmes Rezolutës 1329 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të KB-ve.

³⁵ Shih paragrafin 4 të deklaratës së Carla Del Ponte, Kryeprokurore e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë për Hetimin dhe Ndjekjen Penale të Krimeve të Kryera në Kosovë, Hagë, 29 shtator 1999 në <http://www.icty.org>.

³⁶ Përtej kësaj, prokurorja deklaroi se hetimet mund të kryhen në raste veç e veç, në lidhje me individë tjerë të cilët ka mundësi të kenë kryer “krime veçanërisht serioze [përfshirë dhunën seksuale] gjatë kohës së konfliktit të armatosur.” Shih *id.*

³⁷ Shih Rastin Nr. IT-02-54-T, nga Gjykata Ndërkombëtare Penale e Kombeve të Bashkuara për ish Jugosllavinë, *Prokurori kundër Slobodan Milosevic*, 14 mars 2006, Urdhri për Përfundimin e Procedurës. E qasur me 23 prill 2010 nga http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/tord/en/060314.htm (në dispozicion vetëm në gjuhën angleze).

³⁸ Shih Rastin Nr. IT-05-87-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera

kundër Šainovićit, Ojdanićit, Pavkovićit, Lazarevićit dhe Lukićit aktualisht ndodhet me ankesë. Në rastin Haradinaj *et alia* Brahimaj ishte shpallur fajtor; Haradinaj dhe Balaj ishin shpallur të pafajshëm.³⁹ Rastet kundër tre të akuzuarve aktualisht janë në pritje pranë Dhomës së Ankesave. Në rastin Limaj *et alia*, Bala ishte dënuar; Limaj dhe Musliu ishin liruar.⁴⁰ Rasti kundër Đorđevićit është aktualisht në procedim.⁴¹ Sipas Zyrës Informativë të GJNPJ-së në Kosovë nuk ka raste tjera që rrjedhin nga konflikti në Kosovë të cilat do të gjykohen në Gjykatë, për shkak se mbyllja e GJNPJ-së planifikohet që të ndodh në një të ardhme të afërt.⁴²

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

EULEX-i zyrtarisht filloi punën në Kosovë me 9 dhjetor 2008 dhe në prill të vitit 2009 njoftoi së është plotësisht operacional. Misioni i shprehur i vet është që të monitorojë, mësojë dhe këshillojë, përderisa mban disa fuqi të kufizuara ekzekutive në fushën e sundimit të ligjit.⁴³ EULEX-i punon nën kornizën punuese të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kryesisht në drejtësi, polici dhe shërbimin e doganave.

në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, *Prokurori kundër Milutinovic et alia*, aktgjykimi i 26 shkurtit 2009, paragrafët 1206-1213. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/en/jud090226-e3of4.pdf> Aktgjykimi i plotë është në dispozicion vetëm në gjuhën angleze. Për një përmbledhje të tij ju lutem shihni: http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226sq_judg_summary.pdf e qasur me 23 prill 2010.

³⁹ Shih Rastin Nr. IT-04-84-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, *Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj*, aktgjykimi i 03 prillit 2008, paragrafët 502-505. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/080403.pdf>.

⁴⁰ Shih Rastin Nr. IT-03-66-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, *Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu*, aktgjykimi i 30 nëntorit 2005, paragrafët 738-743. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/limaj/tjug/sq/051130.pdf>. Për ankesën shih Rastin Nr. IT-03-66-A, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, *Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu*, aktgjykimi i 27 shtatorit 2007, Pjesa Shtatë, Vendim. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/limaj/acjug/sq/070927.pdf>.

⁴¹ Shih Rastin Nr. IT-05-87-1, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, *Prokurori kundër Đorđević*. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/case/djordjevic/4>.

⁴² “Përlllogaritjet që nga vera e vitit 2009 sugjerojnë se të gjitha, përpos tri rasteve të gjykimeve në GJNPJ, do të përfundojnë në vitin 2010, dy të tjerë në fillim të vitit 2011, dhe gjykimi i fundit, ai kundër Karadićit, në fillim të vitit 2012. E shumta e punës lidhur me ankesa parashihet të përfundohet nga fundi i vitit 2012, më një numër të vogël rastesh që do zgjasin deri nga gjysma e parë e vitit 2013.” Shih *Vlerësim dhe raport i Gjyqtarit Patrick Robinson, Kryetar i Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, të dhënë para Këshillit të Sigurimit bazuar në paragrafin 6 të Rezolutës 1534 (2004) të Këshillit*, që mbulon periudhën prej 15 maj deri me 15 nëntor 2009, S/2009/589/. E qasur me 23 prill 2010 në http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/CompletionStrategy/completion_strategy_13nov2009_en.pdf (raporti në dispozicion vetëm në gjuhën angleze).

⁴³ Veprimi i Përbashkët i Këshillit të Evropës 2008/124/CFSP mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX Kosovë, 4 shkurt 2008, Neni 2.

Një pjesë e mandatit të theksuar të EULEX-it është që në mes tjerash të “sigurojë se rastet e krimeve të luftës [...]dhe krimet tjera serioze hetohen, ndiqen penalisht, gjykohen dhe zbatohen në mënyrë të duhur, në pajtim me ligjin e aplikueshëm, duke përfshirë këtu, aty ku është e përshtatshme, nga hetues, gjyqtarë e prokurorë ndërkombëtar së bashku me hetues, gjyqtarë e prokurorë të Kosovës ose në mënyrë të pavarur” dhe të marrin masa që të sigurojnë “në mënyrë të duhur, krijimin e strukturave të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë.”⁴⁴ Ka mbi 40 gjyqtarë ndërkombëtar që aktualisht punojnë në EULEX,⁴⁵ megjithatë asnjëri nga ata nuk është ekskluzivisht i dedikuar për të trajtuar rastet e krimeve të luftës.⁴⁶ Kolegjet e mbledhura për gjykime të rasteve të krimeve të luftës, normalisht përbëhen nga dy gjyqtarë ndërkombëtar dhe një gjyqtar vendor.⁴⁷ Prokurorët që punojnë në rastet e krimeve të luftës, që përshkruhet më poshtë, nuk punojnë së bashku me prokurorët vendor.

Ka përafërsisht 20 prokurorë ndërkombëtar që punojnë për EULEX-in. Megjithatë, ka vetëm dy prokurorë plotësisht të dedikuar për raste të krimeve të luftës,⁴⁸ të cilët janë pjesë të Prokurorisë Speciale.⁴⁹ Veç kësaj, këta dy prokurorë ndihmohen nga një zyrtar ligjor, një këshilltar ligjor dhe një asistent administrativ. Megjithatë, personeli mbështetës ka po ashtu për detyrë të punojë në lloje të tjera të lëndëve. Njësitë Hetimor për Krime Luftë ka një tabelë personeli prej 35 personave: megjithatë ka shumë hapësirë që të arrihet kjo objektivë.

⁴⁴ *Id* në Nenin 3 (d).

⁴⁵ Komponenti i Drejtësisë, EULEX Kosovë. E qasur me 28 prill 2010 nga <http://www.eulex-kosovo.eu/?id=10>.

⁴⁶ Sipas informacionit që kanë marr monitoruesit e OSBE-së.

⁴⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale në Kosovë dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi Kaktimin dhe Ndërrimin e Vendit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar.

⁴⁸ Intervistë më një zyrtar nga EULEX-i, 29 prill 2010.

⁴⁹ Prokuroria Speciale (“PS”) ishte themeluar si një zyrë prokurorie e specializuar dhe e përhershme që punon brenda Zyrës së Prokurorit të Kosovës në vitin 2008. Shih Ligjin Nr. 03/L-052 mbi *Prokurorinë Speciale*, 13 mars 2008, Gazeta Zyrtare e Kosovës 27/2008. Neni 5 i ligjit thotë se PS “[...]do të ketë kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krimet e: [...]gjenocidit [...]; krimet kundër njerëzimit [...]; krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës [...]; krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar [...]; krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës: [...] krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar [...]; sulmet në konfliktet e armatosura të një karakteri jo ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme [...]; rekrutimi dhe regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në konfliktin e armatosur[...]; përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit[...]; organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës [...]; rrezikimi i personave në mbrojtje ndërkombëtare [...]; përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve nukleare [...]; të gjitha krime të numëruara në Nenet 141-155 të LP të RFJ-së”. Veç kësaj, Neni 5.2 I ligjit thotë se PS “gjithashtu do të ketë kompetencë të veçantë për hetimin dhe ndjekjen e krimeve, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim të:[...]; të gjitha krimet e numëruara në Nenet 141-155 të LP të RFJ-së.”

Deri në fund të vitit 2009, prokuroria e EULEX-it ka gjykuar katër raste të krimeve të luftës, më një numër total prej tetë personave të gjykuar. Nga këta, shtatë të pandehur ishin dënuar dhe njëri vdiq derisa gjykimi ishte në procedurë.⁵⁰

Vonesat

Një nga problemet kronike lidhur me adresimin e rasteve të krimeve të luftës në Kosovë ka qenë ai i vonesës në sjelljen e këtyre rasteve në shqyrtim të plotë. Shkelje si të kornizës ligjore të Kosovës ashtu edhe të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut mund të ngjajnë kur procedurat dhe gjykimet penale zgjasin paarsyeshëm shumë. Për më tepër, sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, çdo i arrestuar apo i paraburgosur ka “të drejtë për gjykim brenda kohës së arsyeshme ose që të lirohet në pritje të gjykimit.”⁵¹

Vonesat mund të ndodhin në shumë faza të procedurës, përfshirë këtu: fazën e hetimit policor, fazën e ndjekjes penale/hetimit, fazën e gjykimit dhe fazën e ankesës. Më poshtë jepet analiza e problemeve dhe parregullsive të cilat kanë mundur të ndodhin në secilën prej këtyre fazave.

Vonesat në fazën e hetimit policor

Disa raste kanë marr vite që të hetohen dhe, ose nuk kanë arritur fare në zyrën e prokurorit ose kanë arritur vetëm disa vite prej kur kanë ndodhur veprat e pandehura penale. Shumica e rasteve të krimeve të luftës fillimisht ishin hetuar nga zyrtarët e CIVPOL-it dhe hetuesit nga GJNPJ-ja. Zyrtarët e SHPK-së, parimisht nuk ishin të përfshirë në hetimin e rasteve të krimeve të luftës në ditët e hershme pas konfliktit, përpos nganjëherë kur kanë ndihmuar, siç është marrja në pyetje e ndonjë dëshmitari. Përderisa personeli hetimor nga GJNPJ-ja ishte mjaft i qëndrueshëm, shumica e zyrtarëve të CIVPOL-it ndërroreshin çdo gjashtë muaj deri në një vit, zakonisht pa ndonjë dorëzim detyrash nga paraardhësi tek pasardhësi.⁵² Ky ndërrim i hetuesve ndërkombëtar brenda dhe jashtë Kosovës rezultoi në një përfundim të ngadalshëm apo mos-përfundim të hetimeve. Shumë zyrtarë që vinin nuk kishin përvojë në hetimin e krimeve të luftës, dhe këtyre zyrtarëve të rinj që vinin dhe të cilëve për detyrë ju caktohej hetimi i këtyre rasteve, nuk ju ofrua domosdoshmërisht ndonjë trajnim i specializuar në këtë sferë. Veç kësaj, adaptimi në punë në Kosovë, dhe themelimi i rrjeteve përbënte humbje kohe që përsëritej me secilën ardhje të re. Ndërrimi i

⁵⁰ Komponenti i Drejtësisë, EULEX Kosovë. E qasur me 23 prill 2010 nga <http://www.eulex-kosovo.eu/?id=10&j=52>.

⁵¹ Neni 5(3) KEDNJ. Lirimi mund të kushtëzohet me garanci për t'u paraqitur në gjykim. *Id.*

⁵² Shih *Auditimi Menaxherial i Operimeve Policore të Kombeve të Bashkuara*, pjesa e *Shqyrtimit të efikasitetit të funksionimit administrativ dhe financiar të Kombeve të Bashkuara*, *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Zyrës së Shërbimeve për Mbikëqyrje*. A.55.812, Seanca e pesëdhjetë e pestë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Pikat 116 dhe 126 të Agjendës, 1 mars 2001. E qasur me 29 prill 2010 nga http://www.un.org/Depts/oios/reports/a55_812.pdf. Paragrafi 63 thotë se “[K]ujtesa institucionale e komponentit të policisë civile të një misioni humbet çdo herë kur anëtarët kryesor ndërrohen në fund të detyrës së tyre, pasi që informacioni i rëndësishëm lidhur me kompleksitetin e një misioni shpesh nuk dokumentohet apo bartet kur ka një ndryshim në kryesi.[...] Njësitë e Policisë Civile nuk mbledh kurrfarë të dhënash mbi përvojat e policisë civile e as sugjerime për përmirësim. Kjo rezultoi me një humbje të konsiderueshme të kujtesës institucionale dhe në mos-regjistrimin e përvojave të misionit para se policët individual të kthehen në vendet e tyre [...]” Paragrafi 66 thotë se “[p]olicia civile shkon në detyrë për një kohë prej gjashtë muajsh deri në një vit, varësisht nga politikat e vendit kontribuues[...].”

hetuesve ndërkombëtar gjithashtu nënkuptonte se këta hetues shpesh nuk gjendeshin më në Kosovë për të qenë në dispozicion që të dëshmojnë në seanca dëgjimore kur kjo nevojitej.

Vonesat në fazën e hetimit të prokurorisë

OSBE ka vërejtur vonesa të shpeshta ndërmjet kohës kur aktakuza është ngritur nga prokurorët, dhe konfirmimin e tyre nga gjykatat.⁵³ Korniza ligjore në Kosovë parasheh se gjyqtari do ta caktojë menjëherë seancën e konfirmimit, pasi që ai apo ajo të vlerësoj se aktakuza është e përpiluar në mënyrë të duhur.⁵⁴ Megjithatë, në shumë raste të krimeve të luftës, aktakuzat ngriteshin me vonesë të konsiderueshme nga ana e prokurorëve. Kjo në radhë të parë ndodhte për shkak se shkresat e lëndëve pranoheshin nga hetuesi shumë kohë më vonë pas ngjarjeve në fjalë, dhe shumë herë ato nuk ishin të kompletuara, duke shfaqur nevojën për hetim të mëtejshëm nga prokurori. Prokurorët në shumë raste është dashur të ri-konfirmojnë të shumtën e dëshmive dhe/ose të shqyrtojnë dëshmi të reja aty ku kishte zbrazëtira. Vonesa të mëtejme ndodhën kur shkresat e lëndëve transferoheshin nga prokurorët vendor tek prokurorët e UNMIK-ut,⁵⁵ ose ndërmjet prokurorëve ndërkombëtar. Përkthimi i shkresave të lëndëve kur rastet dorëzoheshin nga vendorët tek ndërkombëtarët gjithashtu merrte kohë, dhe humbja ose keq-vendosja e të dhënave ngjante gjatë përkthimit kur disa shkresa të lëndëve nuk përmbanin një indeks të dokumenteve që ishin në të. Veç kësaj, kur gjyqtari hetues ishte hequr nga sistemi gjyqësor⁵⁶ ajo punë ra në barrë të prokurorit. Megjithatë, nuk ka pasur shtim në numrin e prokurorëve, kështu që po ai numër prokurorëve kishte më shumë punë për të bërë. Për shkak të dy këtyre faktorëve, u deshën muaj të tërë të kalojnë para se përfundimisht të konfirmohen shumë aktakuza për krime lufte. Për shembull:

Vepra të ndërlidhura me krime lufte ishin kryer nga një shqiptar i Kosovës me 12 korrik 1998. Megjithatë, kallëzimi penal ishte parashtruat në nëntor 2006, d.m.th. tetë vjet pas kryerjes së veprave të pandehura. Aktakuza ishte ngritur një vit më vonë, me 14 nëntor 2007. Shqyrtimi kryesor filloi me 3 shkurt 2009 dhe aktgjykimi u shpall me 3 mars 2009.⁵⁷ I pandehuri u shpall fajtor dhe u dënua me 17 vjet burg. Kaluan gati njëmbëdhjetë vite prej kryerjes së veprave në fjalë deri te shpallja e aktgjykimit.

⁵³ Kjo është e vërtetë për rastet e trajtuar pas miratimit të Kodit të Përkohshëm Penal dhe Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës në vitin 2003. Para asaj kohe procedura ishte ndryshe, pasi që ka qenë gjyqtari hetues ai që ishte përgjegjës për aprovimin ose mos-aprovimin e aktakuzës.

⁵⁴ Shih Nenin 309(1), KPPPK. Në mënyrë që gjyqtari të caktojë seancën për konfirmim, aktakuzaduhet të jetë e përpiluar në përputhje me kushtet nga Neni 305.

⁵⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi Caktimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar dhe/apo Ndërrimin e Vendit, e cila hyri në fuqi me 15 dhjetor 2000, i dha prokurorëve kompetent, të akuzuarve ose avokatëve mbrojtës të drejtën e peticionit ndaj Departamenti Administrativ të Drejtësisë së UNMIK-ut (DAD) për caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar kur ishte e “domosdoshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit ose administrimin e duhur të drejtësisë.” Në mungesë të peticionit, DAD mund të vepronte po ashtu bazuar edhe në kundërshtim të vetin. Pas peticionit, DAD kishte për detyrë të rishikonte peticionin dhe të jepte rekomandime për PSSP-në për aprovim përfundimtar apo refuzim. Kur një peticion aprovohej, kolegji mund të përbëhej nga një prokuror ndërkombëtar dhe një gjyqtar hetues ndërkombëtar dhe/ose kolegji i përbërë prej tre gjyqtarëve, përfshirë këtu së paku dy gjyqtarë ndërkombëtar.

⁵⁶ Për shkak të hyrjes në fuqi të KPPPK-së në vitin 2004.

⁵⁷ *Prokurori Publik kundër Gani Gashit.*

Në disa raste tjera, hetimet para konfirmimit ishin vonuar për shkak se, edhe pse të dyshuarit u futën brenda sistemit gjyqësor, nuk u morën masa adekuate për të siguruar praninë e tyre gjatë procedurave. Shembujt në vijim ilustrojnë këtë shqetësim:

Në një rast të krimeve të luftës pranë gjykatës së qarkut në Prizren, një i pandehur serb i Kosovës dyshohej se me gjasë kishte kryer krime kundër njerëzimit⁵⁸ gjatë viteve 1998 dhe 1999 dhe kërcënim⁵⁹ në gusht 2009. I pandehuri u vendos në paraburgim dhe rasti u transferua nga prokuroria publike në Prizren tek Prokuroria Speciale Publike në Prishtinë/Priština për hetim të mëtuqjeshëm. Masa e paraburgimit ishte ndryshuar në paraqitje në stacion policor. Megjithatë, pas lirimimit nga paraburgimi, i pandehuri iku nga juridiksioni dhe aktualisht gjendet në arrati.⁶⁰

Me 12 mars 2008, një i zhvendosur i brendshëm, serb i Kosovës, ishte duke marr pjesë në një vizitë shko dhe shiko⁶¹ në fshatin Vitomiricë/Vitomirica, në komunën Pejë/Peć. Në po të njëjtën ditë, personi u arrestua nga Njësi i Krime Lufte të UNMIK-ut, për dyshimin e kryerjes së krimeve të luftës kundër popullatës civile në maj 1999. Me 14 mars, një prokuror publik ndërkombëtar morri përsipër fillimin e hetimeve dhe propozoi paraburgim për të dyshuarin. Me 15 mars 2008 një gjyqtar ndërkombëtar i procedurës paraprake, urdhëroi arrest shtëpiak për të pandehurin, që ta mbante në shtëpinë e një banori serb të Kosovës nga fshati Brestovik i komunës së Pejë/Peć.⁶² Me 28 korrik 2008, u hoq masa e arrestit shtëpiak dhe i dyshuari ishte i obliguar që rregullisht të paraqitet në stacion policor. Aktualisht, një aktakuzë kundër të dyshuarit është në pritje për konfirmim. Ai shkeli masën alternative të vendosur nga gjykata, iku nga juridiksioni dhe aktualisht gjendet në arrati.⁶³

Vonesat në fazën e gjykimit

Edhe pse disa raste të krimeve të luftës kanë shkuar në gjykim shpejtë pasi që janë paraqitur në gjykatë, në shumë raste, ato kanë mbetur në listën e shqyrtimeve të gjykatës për vite të tëra dhe nuk u caktuan për gjykim. Sipas ligjit, kryetari i kolegjit

⁵⁸ Neni 117(1)(1) dhe (4) të KPPK-së. Me gjasë, i pandehuri si pjesëtar i Ushtrisë Jugosllave ishte i përfshirë në sulme sistematike ndaj popullatës civile, mori pjesë në vrasjen e popullatës së pambrojtur shqiptare në depërtimin dhe përzënien e dhunshme të popullatës dhe djegien e shtëpive të tyre në fshatrat Reti dhe Gornje Sellë/Gornje Selo, dhe po ashtu mori pjesë në djegien e ndërtesës së Lidhjes të Prizrenit në Prizren.

⁵⁹ Neni 161(1) KPPK.

⁶⁰ Rasti *Prokurori Publik kundër Goran Vuckovic*.

⁶¹ Sipas *Doracakut të ripunuar për Kthim të Qëndrueshëm*, vizita shko dhe shiko (VSHSH) është “një aktivitet i fokusuar në PZHBV-të dhe refugjatët i cili duhet të ndihmojë ata që të marrin vendime lirshëm dhe të informuar mirë për zgjidhjen e qëndrueshme që ata preferojnë, e cila është në përputhje me kontekstin e përgjithshëm për promovimin e krijimit të kushteve të favorshme për një kthim vullnetar të sigurt dhe me dinjitet. Objektivi i VSHSH-së përfshinë krijimin e kushteve që të zhvillohet një dialog ndëretnik në mes të personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve dhe komunitetit shumicë.” Shih *id.* në faqet 32-34.

⁶² Kjo masë është në kundërshtim me kushtet ligjore, të cilat parashohin vendosjen e masës së arrestit shtëpiak në vendbanimin aktual ose të përhershëm të të paraburgosurit, ose në një vend apo institucion përkujdesjeje ku i paraburgosuri mund të merr trajtim publik, po që se kjo është e nevojshme. (Shih Nenin 278(3) KPPK). Edhe pse vendimi tregon vendin ku do të qëndrojë i pandehuri, ky vend prapë nuk është “vendbanimi i tij aktual apo i përhershëm” siç e parasheh ligji, por banesa e një familjeje, jo e lidhur me të akuzuarin, i cili pranoi të strehojë të paraburgosurin.

⁶³ Rasti *Prokurori Publik kundër Momcilo Jovanovic*.

do të caktojë shqyrtimin kryesor menjëherë kur aktakuza të merr formën e prerë.⁶⁴ Një nga arsytet e vonesave në këtë lloj të rasteve është se si dëshmitarët ashtu edhe të pandehurit (ata që nuk kanë qenë në paraburgim) nuk janë paraqitur rregullisht në gjykim. Megjithatë në praktikë, e vetmja pasojë e mosparaqitjes së dëshmitarit në gjykim ka qenë shtyrja e seancës për një datë tjetër, edhe pse ligji lejon vendosjen e disa sanksionimeve. Në fund, është përgjegjësia e kryetarit të trupi gjykues që të sigurojë që shqyrtimi kryesor të caktohet brenda kohës së duhur. Më poshtë është vetëm një shembull i vonesës së paarsyeshme ndërmjet finalizimit të aktakuzës dhe caktimit të seancës së parë të gjykimit.

Në një rast, një i pandehur shqiptar i Kosovës ishte ngarkuar për kryerje të veprës penale krime të luftës kundër popullatës civile duke kryer, urdhëruar, ndihmuar, kryer nga pakujdesia, vepruar në bashkëpunim me të tjerët dhe duke marr pjesë në një planifikim të përbashkët kriminal, për qëllim të kryerjes së krimeve të luftës.⁶⁵ Aktakuza mori formën e prerë me 8 prill 2005, dhe seanca e parë ishte caktuar për datë 29 shtator 2005. Më shumë se pesë muaj kishin kaluar nga koha kur aktakuza mori formën e prerë deri te seanca e parë.⁶⁶

Vonesat në fazën e ankesës

Kur rastet janë të përfunduara në fazë të gjykimit, shpesh ato shkojnë me ankesë pranë Gjykatës Supreme. OSBE ka monitoruar shumë shembuj të vonesave në këtë fazë të procedurës ankimore. Sipas Nenit 408 të KPPPK-së, gjykata e shkallës së parë do të ja dorëzojë një kopje të ankesës palës kundërshtarë⁶⁷ e cila mund të parashtrojë një përgjigje ndaj ankesës në gjykatë brenda tetë ditëve nga pranimi i kopjes. Gjykata e shkallës së parë do të dorëzojë ankesën, përgjigjen ndaj ankesës dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën e shkallës së dytë. Megjithatë, në shumë raste të monitoruara, prokuroria nuk veproi në përputhje me afatin kohor prej tetë ditësh për parashttrim të përgjigjes. Prania ndonjëherë e vetëm një prokurori ndërkombëtar që përgjigjej në të gjitha ankesat penale, jo vetëm në ankesat për rastet e krimeve të luftës mund ti ketë kontribuar vonesave në procedurë, dhe është një shembull tjetër i dështimit për të ofruar resurse adekuate. Veç kësaj, në disa raste, monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur se disa parashtresa, kryesisht mendimet e prokurorëve lidhur me ankesa,⁶⁸ ju ishin dorëzuar mbrojtjes vetëm disa minuta para fillimit të seancës, duke i cenuar mbrojtjes mundësinë për të përgatitur plotësisht rastin e vet ose përgjigjen lidhur me pikat nga mendimi mbi ankesën.⁶⁹

⁶⁴ Neni 319 (2) KPPPK.

⁶⁵ Neni 142 i Ligjit Penal të Jugosllavisë (LPJ), në lidhje me Nenin 24, 30, 22 dhe 26 të LPJ-së.

⁶⁶ *Prokurori Publik kundër Selim Krasniqi et alia*.

⁶⁷ Nenet 127 dhe 128 KPPPK.

⁶⁸ Rasti *Prokurori Publik kundër Momčilo Trajković*, seanca dëgjimore pranë Gjykatës Supreme me 30 nëntor 2000. 50 faqe të Mendimit të Prokurorit u ishin dërguar mbrojtjes disa minuta para fillimit të seancës. Rasti *Prokurori Publik kundër Miroslav Vucković*, seanca dëgjimore pranë Gjykatës Supreme me 31 gusht 2001. Mendimi i Prokurorit prej 40 faqesh u ishte dorëzuar avokatëve mbrojtës serb vetëm disa minuta para fillimit të seancës, vetëm në gjuhën angleze, d.m.th. të pa përkthyer.

⁶⁹ Neni. 6 (1) dhe 6 (3) (a) (b); Neni. 15 KPPPK. E drejta në gjykim kontradiktor “në parim nënkupton mundësinë e palëve [. . .] për të pasur njohuri dhe për të komentuar të gjitha dëshmitë e administruara dhe mocionet e parashtruara [. . .] me qëllim të ndikimit në vendim të gjykatës.” *Vermeulen kundër Belgjikës*, GjEDN, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1996, paragrafi 33. Për më tepër, “autoritetet e prokurorisë duhet të ja ofrojnë mbrojtje të gjitha dëshmitë materiale që kanë në

Veç kësaj, ka pasur vonesa të dukshme në Gjykatën Supreme, si në caktimin e seancave dëgjimore ashtu edhe në nxjerrjen e vendimeve. Kur një vendim merrej përfundimisht, ka pasur vonesa thelbësore në lëshimin e aktgjykimeve me shkrim, gjë që edhe kësaj radhe stagnoi procedurën. Gjykata Supreme ka kthyer shumë raste të krimeve të luftës në gjykata më të ulëta për rigjykim, në të cilën pikë i tërë procesi fillon që nga e para.⁷⁰

Rastet e mëposhtme shërbejnë si shembuj të vonesave shpesh të vërejtura gjatë fazës ankimore në rastet e krimeve të luftës.

Me 30 shtator 2005 filluan hetimet kundër një shqiptari të Kosovës, i dyshuar për kryerje të veprës penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile.⁷¹ Aktakuza kundër të pandehurit ishte ngritur me 8 shkurt 2007. Një kolegji i përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtar pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć, me 22 qershor 2007 e shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi atë me 15 vite burg. Avokatët mbrojtës parashtuan ankesë kundër aktgjykimit me 19 dhe 22 gusht 2007. Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës japi përgjigje në këto ankesa pas 17 muajve, me 16 janar 2009. Me 2 qershor 2009, Gjykata Supreme mori vendimin për ta kthyer rastin në rigjykim pranë gjykatës së qarkut.⁷²

Në një tjetër rast të krimeve të luftës, një i pandehur shqiptar i Kosovës ishte akuzuar për kryerje të veprës penale krime të luftës kundër popullatës civile, të kryera me 12 korrik 1998. Megjithatë, kallëzimi penal ishte bërë me 14 nëntor 2006, tetë vjet më vonë, dhe aktakuza ishte ngritur me 14 nëntor 2007. Shqyrtimi kryesor kishte filluar me 3 shkurt 2009 dhe aktgjykimi ishte shpallur me 3 mars 2009. I pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 17 vite burg. Brenda afatit të paraparë ligjor, avokati mbrojtës parashtroi ankesa pranë Gjykatës Supreme me 28 prill 2009 dhe 7 maj 2009 kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë (gjykata e qarkut në Prishtinë/Priština). Përgjigja e Prokurorit Publik të EULEX-it ishte dhënë me 2 nëntor 2009, gjashtë muaj pas parashtrimit të ankesave nga mbrojtja. Gjykata Supreme aprovoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe uli dënimin në 15 vite dënim me burg.⁷³

Shembujt e mësipërm tregojnë përse aq shumë raste kanë zgjatur me vite të tëra për të kaluar në faza të ndryshme të procedurës. Kjo vonesë përbën shkelje të drejtës së pandehurit për dëgjimin e rastit të tij/saj brenda një kohe të arsyeshme.⁷⁴ Për shkak se në shumë raste të krimeve të luftës i pandehuri mbahet në paraburgim, këto raste duhet të procedohen në mënyrën më të shpejtë të mundshme.⁷⁵ Por të dhënat tregojnë

posedim për ose kundër të akuzuarit.” *Edwards dhe Lewis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj, aktgjykimi i 27 tetorit 2004, paragrafi 46.

⁷⁰ E drejta për siguri ligjore, që mund të vihet në pikëpyetje nga këto rigjykime, diskutohet në Kapitullin II të këtij raporti.

⁷¹ Neni 142 LP i RSFJ-së.

⁷² *Prokurori Publik kundër Idriz Gashi*.

⁷³ *Prokurori Publik kundër Gani Gashi*.

⁷⁴ Neni 5(3) KEDNJ dhe Neni 14 (2) KPPPK.

⁷⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), ka deklaruar vazhdimisht se drejta për liri bashkë me të drejtën për jetë, lirinë nga tortura dhe keqtrajtimi, dhe lirinë e lëvizjes, është “në rangun e parë të të drejtave themelore që mbrojnë sigurinë fizikë të një individi [...] dhe si e tillë

se ky nuk ka qenë rasti.⁷⁶ Dhënia e prioritetit për rastet e krimeve të luftës është shumë më me rëndësi nëse vihen në garë me barrën me lëndë të përditshme. Rastet e krimeve të luftës duhet të kenë prioritet si raste që adresojnë incidente që kanë pasur ndikimin më të madh në popullatë.

Një shembull i fundit se si rastet janë duke lëvizur ngadalë përgjatë sistemit gjyqësor është rasti *Prokurori Publik kundër Latif Gashi, et alia*.⁷⁷ Në këtë lëndë, aktakuza ishte ngritur me 19 nëntor 2002, lidhur me krime të pandehura që kanë ndodhur në vitet 1998 dhe 1999. Shqyrtimi kryesor filloi me 20 shkurt 2003 dhe aktgjykimi ishte shpallur me 16 korrik 2003, përderisa aktgjykimi me shkrim nuk ishte lëshuar deri me 11 nëntor 2003. Megjithatë, Neni 356 (1) i LPP i RSFJ-së thotë se “në rastet e ndërlikuara dhe si përjashtim”; rregulla e përgjithshme e lëshimit të aktgjykimit me shkrim brenda 8 ditëve pas shpalljes së tij mund të shtyhet deri në 15 ditë. LPP i RSFJ-së i jep autoritet të gjerë për liri veprimi kryetarit të gjykatës kur thotë se “kryetari i gjykatës do t’i merr të gjithë hapat e domosdoshëm për të përgatitur aktgjykimin me shkrim sa më parë që të jetë e mundur.” Në këtë rast të veçantë, u deshëm gati pesë muaj që të lëshohet aktgjykimi me shkrim. Më pastaj, u parashtruan ankesa pranë Gjykatës Supreme e cila hodhi poshtë disa nga pikat e aktakuzës dhe e ktheu rastin në rigjykim. Rigjykimi nuk filloi deri me 7 korrik 2009. Me 2 tetor 2009, trupi gjykues shpalli aktgjykimin me të cilin gjeti fajtorë të gjithë të pandehurit në këtë rast. Aktgjykimi me shkrim është akoma në pritje. Sipas Nenit 356(1) të LPP së RSFJ-së, afati i jashtëzakonshëm prej 15 ditëve veçse është shkelur. Mbrojtësit e të pandehurve kanë shfaqur synimin e tyre për ankesë, andaj ky rast, i cili deri më tani ka zgjatur shtatë vjet, sipas të gjitha gjasave do të zgjat edhe më shumë.

Mungesa e vazhdimësisë në personelin gjyqësor

Një problem shtesë që është vënë në dukje në përbërjen e tanishme është aspekti i largimit të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë nga Kosova gjatë shqyrtimit të një rasti. Kjo është për shkak të kontratave relativisht afatshkurtra dhe delegimit të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë që punojnë në Kosovë. Shumë prej këtyre gjykatësve dhe prokurorëve mbajnë postet e tyre në juridiksionin e vendit të tyre dhe mund të qëndrojnë në Kosovë për një periudhë të caktuar, ndonjëherë jo më shumë se një ose dy vite. Gjykimet megjithatë mund të zgjasin me vite, dhe siç është përshkruar më sipër, mund të kalojnë shumë vite para se rastet të përfundojnë krejtësisht. Kur gjyqtarët lëshojnë juridiksionin para se gjykimi të përfundojë plotësisht, dhe kështu trupi gjykues nuk është i përbërjes së njëjtë siç ishte në gjykimin e parë, shqyrtimi kryesor duhet të nis prej fillimit, që mund të përfshijë ri-administrimin e provave.⁷⁸

rëndësia e saj është supreme.” Shih, mes tjerash, *Musuc kundër Moldavisë*, GjEDNj, aktgjykimi i 6 nëntorit 2007, paragrafi 37.

⁷⁶ OSBE më parë ka shfaqur shqetësime se zbatimi joadekuat i kornizës ligjore të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut rezulton në shkelje të shpeshta të së drejtës së të pandehurit në liri në rastet penale. Shih mes tjerash, Raporti i OSBE-së i vitit 2009 mbi *Përdorimi i Paraburgimit në Procedurat Penale në Kosovë: Shqyrtim dhe Analizë Gjithëpërfshirëse e Brengave të Mbetura, Pjesa I*.

⁷⁷ *Prokurori Publik kundër Latif Gashi, Rrustem Mustafa, Naim Kadriu dhe Nazif Mehmeti*.

⁷⁸ Shih Nenin 345 (1) dhe 344 (3) KPPPK: “(1) Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet

III. GJETJET DHE SHQETËSIMET

Një shqyrtim i kujdesshëm i rasteve të krimeve të luftës në Kosovë vë në pah një numër shqetësimesh. Gjatë periudhës së raportimit, ka pasur një mungesë të prioriteteve të rasteve të krimeve të luftës brenda sistemit gjyqësor. Nuk janë ndarë kurrë resurse adekuate për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës në Kosovë. Anëmbanë ish-Jugosllavisë, si dhe në zonat tjera të konfliktit rreth botës, rastet e krimeve të luftës janë dëshmuar gjithmonë të jenë raste vështira për t'u hetuar dhe gjykuar plotësisht. Si pasojë, nevoja për caktimin e resurseve të mjaftueshme për këtë qëllim pas konfliktit në Kosovë, ishte e parashikueshme. Megjithatë, ka pasur edhe një rutinë të rregullt gjatë dekadës së fundit që ka lejuar rastet e përditshme të vihen përsipër punës afatgjatë për të trajtuar rastet e krimeve të luftës.

Këto raste veç sa bëhen më vështirë të zgjidhen, aq sa më të vjetra bëhen prej ngjarjeve në fjalë. Disa viktime dhe dëshmitarë kanë vdekur, disa janë shpërngulur dhe kujtesa e disa të tjerëve është zbehur me kalimin e kohës. Dëshmitë janë zhvendosur ose shkatërruar, pjesërisht nga dorëzimet e shumta nga gjeneratat e ndryshme të akterëve të përfshirë në këto raste. Shumë nga hetuesit, shumica dërmuese e të cilëve kanë qenë ndërkombëtar, ka kohë që kanë lëshuar juridiksionin dhe nuk janë më në gjendje të marrin pjesë në gjykim dhe të paraqesin dëshmitë e as të japin deklaratata lidhur me rolin e vet në hetime.

Duke lejuar më shumë kohë të kalojë pas një konflikti vetëm dëmton përpjekjet për të trajtuar rastet e krimeve të luftës. Në Kosovë, ka pasur një numër të rasteve ku dëshmitarët janë vrarë, larguar, kanë tërhequr dëshmitë e tyre të mëparshme, ose thjesht nuk kanë pranuar të japin dëshmi.⁷⁹

Në shumë raste të akuzuarit kanë ikur nga juridiksioni dhe ka shumë pak gjasa që ata të kthehen. Pasi që gjykimet në mungesë nuk janë të lejuara në rastet e krimeve të luftës në Kosovë,⁸⁰ rastet janë pezulluar për një kohë të pacaktuar. Po që se këto raste do të ishin trajtuar menjëherë pas konfliktit, shumë nga problemet e mësipërme do të ishin lehtësuar, duke përfshirë sigurimin e pranisë së personave të akuzuar në gjykim. Siç qëndron tanimë, do të jetë jashtëzakonisht e vështirë për të gjykuar të gjitha rastet e tjera.

Bashkëpunimi i pamjaftueshëm rajonal po ashtu ka penguar procesin e gjykimit të rasteve të krimeve të luftës. Është e mundshme që disa persona të akuzuar për krime të luftës kanë ikur nga Kosova dhe ata mund të gjykohen në një tjetër juridiksion. Megjithatë, në mënyrë që të zgjerojnë këtë proces dhe të gjykojnë të dyshuarit që kanë ikur nga Kosova, prokurorët dhe hetuesit jashtë Kosovës do të duhet të kenë qasje në dëshmi dhe dëshmitarë në Kosovë. Për këtë do të nevojitej bashkëpunim zyrtar mes

këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.[...] (3) Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.”

⁷⁹ Për shembull, dëshmia e dhënë pranë hetuesve dhe/ose në një procedurë të mëhershme gjyqësore. Shih diskutim dhe shembuj specifik mbi këtë, të monitoruara nga OSBE në Raportin, *Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë, Shqyrtim*. E qasur me 23 prill 2010, http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf.

⁸⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/1 mbi Ndalimin e Gjykimeve në Mungesë për Shkelje Serioze të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar e shpallur me 12 janar 2001.

zyrtarëve brenda dhe jashtë Kosovës, që aktualisht nuk ekziston.⁸¹ Bashkëpunimi ndër-juridik është i nevojshëm në të gjithë rajonin, për çështje siç është gjetja e vendndodhjes së të akuzuarit dhe dëshmitarëve për gjykim.

Aktgjykimet përfundimtare

Një çështje tjetër që u ngrit gjatë këtij vlerësimi është ajo e aktgjykimeve përfundimtare. Sipas parimit *res judicata*, artikulluar nga jurisprudenca e GjEDNj, "ku gjykatat kanë vendosur përfundimisht mbi një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në dyshim."⁸² Në ditët e hershme pas konfliktit një numër i vendimeve ishin lëshuar nga kolegjet gjyqësore, të themeluara sipas Rregulloreve të UNMIK-ut.⁸³ Kjo përfshinte një gjyqtar ndërkombëtar; shumica e kolegjit ende përbëhej nga gjyqtarë vendor, zakonisht me një përbërje prej dy gjyqtarëve vendor profesional, dy gjyqtarëve porotë vendas dhe një gjyqtari ndërkombëtar. Më vonë, pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut 2001/64,⁸⁴ përbërja e kolegjeve është ndryshuar në atë mënyrë që shumica e anëtarëve të kolegjit do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë. Gjykata Supreme e Kosovës shumicën e rasteve më parë të gjykuara i ktheu prapa në rigjykim. Të ashtuquajturat "panelet 64"⁸⁵ që drejtonin rigjykimet, për pjesën më të madhe të rasteve, nxjerrën vendime të ndryshme. Gjykata Supreme ka kthyer prapa raundin e dyte të rasteve të krimeve të luftës, edhe në një tjetër rigjykim, nga kolegjet e përbëra me shumicë nga gjyqtarë të EULEX-it.

Konfuzioni lidhur me atë se cili ligji duhet të zbatohet në rastet e krimeve të luftës, veçanërisht në vitet e hershme pas konfliktit, i ka kontribuar numrit të madh të rigjykimeve në rastet e krimeve të luftës. Ky trend negativ çoi në gabime që rezultuan në prishjet pasuese nga Gjykata Supreme, që i kthente rastet prapa në rigjykim. Ky problem ishte përkeqësuar nga ndryshimet e shpeshta të akterëve ndërkombëtar në sistemin gjyqësor, që vinin nga sisteme të ndryshme gjyqësore dhe kishin interpretime të ndryshme të ligjit, të cilat mund të kenë qenë të ndikuara nga juridiksionet e veta.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur serb i Kosovës ishte ngarkuar me kryerjen e veprës penale të gjenocidit.⁸⁶ Me 18 janar 2001, gjykata e qarkut në the Mitrovicë/Mitrovica e dënoi atë me 14 vjet burgim. Duke vendosur sipas ankesës, me 31 gusht 2001 Gjykata Supreme e Kosovës, e ktheu prapa rastin në rigjykim. Me 25 tetor 2002 gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica me përbërje nga vetëm gjyqtarë ndërkombëtarë, shpalli të pandehurin fajtor për kryerjen e veprës penale të krimeve kundër popullatës civile dhe e dënoi atë me 12 vite burgim. Me 15

⁸¹ Qendra për Ligjin Humanitar ka ndihmuar në këtë proces gjatë viteve, në gjëra të tilla si ofrimin e transportit për dëshmitarët që banojnë në Kosovës dhe nevojiten për gjykime të krimeve të luftës në Beograd.

⁸² Shih *Brumarescu kundër Rumunisë*, GjEDNj, aktgjykimi i 23 tetorit 1999, paragrafi 61.

⁸³ Shih mes tjerash Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6 mbi *Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtar dhe Prokurorëve Ndërkombëtar*, 15 shkurt 2000; Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6 mbi *Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtar dhe Prokurorëve Ndërkombëtar*, 29 maj 2000.

⁸⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi *Caktimin e Gjyqtarëve/Prokurorëve Ndërkombëtar dhe Ndërrimin e Vendit* e ndryshuar përmes Rregulloreve Nr2001/34, 2005/50, 2006/60 dhe 2007/21.

⁸⁵ "Panelet 64" u quajtën shpesh kështu për shkak të numrit të Rregullores së UNMIK-ut (2001/64) që rregullonte themelimin e tyre.

⁸⁶ Neni 141 lidhur me Nenin 22 të LP të RFJ-së.

korrik 2004, Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas ankesës e ktheu përsëri rastin në shkallë të parë. Gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, me një kolegji të përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtar, mbajti gjykimin i cili zgjati prej 16 gushtit 2007 deri me 22 maj 2008, dhe përsëri dënoi të pandehurin, kësaj radhe me tetë vite burgim. Duke vendosur sipas ankesës, me 7 tetor 2009, Gjykata Supreme me një kolegji gjykues të përbërë vetëm prej gjyqtarëve të EULEX-it, e liroi të pandehurin nga të gjitha akuzat.⁸⁷

Vlefshmëria e një sistemi ligjor zvogëlohet kur vendimet e gjykatave të krijuara sipas ligjit, më vonë shihen si të dyshuara dhe në masë të madhe kthehen prapa. Nëse ka defekte ligjore me vendime të mëparshme dhe/ose dënime, atëherë ato duhet të rishikohen pas ankesës nga gjykata përkatëse e shkallës së dytë dhe duhet ose të kthehen në rigjykim, ose të merret një vendim përfundimtar nga gjykatën ankimore.

Një shqetësim tjetër është se si mund të ndahet drejtësia në raste të cilat kanë lëvizur pas dhe përpara disa herë brenda sistemit. Një shembull karakteristik i kësaj është rasti Llapi,⁸⁸ i cili tashmë është zhvendosur brenda sistemit për shtatë vite, prej vitit 2002 deri në vitin 2009.⁸⁹ Viktimat dhe dëshmitarët e rasteve të tilla janë duke u rritur çdo herë kur rasti duhet të gjykohej përsëri. Pasi që ligji parasheh se fajësia apo pafajësia e të pandehurit të vendoset plotësisht dhe në mënyrë të drejtë brenda një kohe të arsyeshme,⁹⁰ atëherë të drejtat e të pandehurit duhen në masë të madhe të merren parasysh.

Ekspertiza në procedura gjyqësore që përfshijnë krime të luftës

Në mënyrë që rastet e krimeve të luftës të adresohen në mënyrë të duhur, gjyqtarët, prokurorët, avokatët mbrojtës dhe hetuesit duhet të posedojnë kualifikime të mjaftueshme dhe kompetencë për t'i trajtuar këto raste të ndërlikuara. Domosdoshmëria për kualifikime dhe kompetencë të tillë duhet të ishte ndër arsyetimet parësore për themelimin e një ode të specializuar të gjykatës për trajtimin e veprave serioze siç janë krimet e luftës. Përderisa është e kuptueshme se shumica e individëve që punojnë në sektorin gjyqësor nuk kanë shumë, apo nuk kanë fare trajnim ose përvojë në raste të krimeve të luftës, megjithatë është më rëndësi që këtë ta kenë ata të cilëve u është caktuar të punojnë me këto raste. Ka qenë e dukshme, edhe para se konflikti të përfundojë formalisht, se në Kosovë do të duhet të adresohen çështjet lidhur me krimet e luftës. Akterët dhe organizatat përkatëse në Kosovë, është dashur ta parashikojnë dhe të përgatiten më mirë për këtë nevojë. Individët me përvojë në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës është dashur të identifikohen që në fillim dhe të sjellën në Kosovë për ti adresuar këto raste. Përderisa ka pasur mungesë të trajnimit dhe përvojës në radhë të akterëve brenda sektorit gjyqësor vendor, kjo është dashur të ofrohet në mënyrë të mjaftueshme për të zhvilluar kompetencë vendore në këtë fushë. Në fakt, përgjatë tërë periudhës së raportimit ka pasur mungesë të ekspertizës në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës në radhë të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve mbrojtës dhe hetuesve të cilët ishin caktuar ti trajtojnë këto raste. Madje edhe tani, edhe pse disa gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it kanë

⁸⁷ *Prokurori Publik kundër Miroslav Vuckovic.*

⁸⁸ *Prokurori Publik kundër Latif Gashi, Rustem Mustafa, Naim Kadriu dhe Nazif Mehmeti.*

⁸⁹ Kjo është shtesë mbi faktin se ngjarjet në pyetje pandehet të kenë ndodhur në vitet 1998-1999.

⁹⁰ Neni 5 (3) KEDNJ dhe Neni 14 (2) KPPPK.

përvojë të tillë, ka pasur të tjerë që janë caktuar të punojnë me raste të krimeve të luftës, të cilët kanë pak apo aspak përvojë.

Një shembull i vonshëm i kësaj ka ndodhur në rastin e Grupit të Llapit.⁹¹ Kolegji gjyqësor përbëhej prej dy gjyqtarëve ndërkombëtar dhe një gjyqtari vendor. Anëtari vendor ishte një gjyqtar civil i cili ishte caktuar si anëtar i kolegjit nga ana e kryetarit të gjykatës së qarkut. Ai nuk ka përvojë në raste të krimeve të luftës andaj nuk posedon kompetencë për të qenë pjesëtar i kolegjit në një rast të tillë. Pasi që u shpall aktgjykimi, ky gjyqtar, si pjesë të shpalljes të aktgjykimit, u ankua se ai është gjyqtar civil pa përvojë në lëndë penale, e atëherë në raste të krimeve të luftës dhe si i tillë nuk është dashur të caktohet në këtë rasti.

Këso lloj deklaratash publike nuk ndërtojnë besim të publikut në gjyqësor. Publiku duhet të dijë se zyrtarët gjyqësor që trajtojnë raste specifike janë kompetent për atë fushë të ligjit, në mënyrë që ata të kenë besim në sistem.

Megjithatë, ka pasur përpjekje që të adresohet kjo mungesë e ekspertizës. Për shembull, IGJK ka ofruar një numër trajnimesh lidhur me raste të krimeve të luftës dhe vizita studimi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë.⁹² Për pjesën më të madhe vetëm gjyqtarë dhe prokurorë vendor morën pjesë në këto trajnime. Organizata tjera kanë ofruar po ashtu trajnime lidhur me rastet e krimeve të luftës, por kryesisht ato ishin të shkurta, si seminare një ditore. Është jo-reale të pritët që kushdo të mësojë një fushë të re dhe shumë të ndërlikuar të ligjit në një trajnim që zgjat një ditë. Megjithatë, nëse ndonjë prej këtyre ngjarjeve ndodhin në seri, gjyqtari ose prokurori, mund ose nuk mund të jetë në gjendje të marrë pjesë në secilin trajnim pasues.

Çfarë është e nevojshme në vend të kësaj, është një strategji trajnuese afatgjate për raste të krimeve të luftës, që përfshin orë të ofruara nga ekspertë përmes IGJK-së. Gjyqtarët dhe prokurorët të cilëve u janë caktuar rastet e krimeve të luftës, duhet të kenë kohë të mjaftueshme në mënyrë që të jenë të gjendje të përfundojnë kursin për tu edukuar plotësisht në këtë fushë. Do të jetë një sakrificë afat-shkurtër në mënyrë që të zhvillohet kompetencë afat-gjate. Një tjetër alternativë do të ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të marrin pjesë në një vizitë pune/studimi afat-gjate në GJNPJ për të ndjekur punën e homologëve për një periudhë kohore.⁹³ Për të dyja këto sugjerime me siguri do të duhej financim i donatorëve që ato të bëhen realitet.⁹⁴

Nevoja të njëjta për trajnim ekzistojnë edhe në lidhje me avokatët mbrojtës që përfaqësojnë personat e akuzuar për krime lufte. Në mënyrë që të ketë barazi të

⁹¹ *Prokuroria Publike kundër Latif Gashit, Rustem Mustafës, Naim Kadriut and Nazif Mehmetit.*

⁹² Trajnimet e mëparshme të IGJK-së, kanë përfshirë mes tjerash: diskutime në tryeza të rumbullakëta me juristët ndërkombëtar në Kosovë, ligji i RFJ-së për krime lufte (7 mars 2001 në bashkëpunim me Këshillin e Evropës); seminar për shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar: përvoja e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (GJNPJ) dhe çështjet e ndërlidhura në Kosovë (10-12 maj 2002); dhe një seminar për krime lufte (7-8 qershor 2005).

⁹³ Përsosmërisht, kjo do të ishte për një periudhë së paku një mujore, në vend së për një javë siç është bërë zakonisht.

⁹⁴ Për sugjerime tjera praktike lidhur me ngritjen e kapaciteteve dhe bartjen e njohurive shih raportin e ODIHR “*Mbështetja e Procesit të Tranzicionit: Mësimet e Nxjerra dhe Praktikant më të Mira në Bartjen e Njohurive*”, shtator 2009.

vërtetë armësh, avokatët mbrojtës duhen të jenë në mënyrë të barabartë të kualifikuar që ti përfaqësojnë të akuzuarit. Oda e Avokatëve të Kosovës ende mban disa seminare të shkurtra trajnimi. Megjithatë, këto kryesisht janë trajnime një-ditore me pak ose aspak përcjellje. Është e ditur se është problematike për avokatët mbrojtës që të marrin pjesë në trajnime që zgjasin me javë, për shkak të faktit se secili prej tyre punojnë privatisht, gjë që kërkon vëmendjen e tyre të përditshme. Një zgjidhje *ad hoc* siç janë kurset afatgjata të mbajtura një herë në javë për një periudhë prej disa muajve, do të barazon në përgjithësi trajnimet e ofruara për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe ato për avokatë.

Ndërtimi i kapaciteteve për gjyqtarë dhe prokurorë vendor

Një pjesë e brendshme e rolit të përgjithshëm të komunitetit ndërkombëtar në sektorin e drejtësisë është që të ndihmojnë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm gjyqësor. Si i tillë, gjyqtarët dhe prokurorët vendor duhet të përfshihen krahas krahas homologëve të tyre ndërkombëtar në secilin lloj rasti që është prezent në sistem. Në këtë mënyrë, kompetenca do të mund të zhvillohet derisa punohet së bashku. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar do të duhej të ngritin aktivitetet e tyre në rolin mentorues në lidhje me homologët e tyre vendor.

OSBE konsideron se është e këshillueshme që të vazhdohet të përfshihen gjyqtarë vendor në kolegje, madje edhe në raste të krimeve të luftës, siç ka qenë praktika. Rastet e krimeve të luftës ka shumë gjasa që do të ndodhen në sistem edhe kur gjyqtarët ndërkombëtar të lëshojnë Kosovën. Akuzat për krime lufte nuk kanë të paraparë afat për parashkrim ligjor, andaj një rast i krimeve të luftës mund të ndiqet penalisht tani, ose në çfarëdo kohe në të ardhmen. Një përfitim shtesë jashtë rasteve të krimeve të luftës, në veçanti është se aftësi të tilla janë të nevojshme dhe se sfida të ngjashme siç janë frikësimi i personelit gjyqësor dhe mbrojtja e dëshmitarëve ekzistojnë edhe në raste të tjera të krimeve serioze si krimi i organizuar dhe veprat serioze penale etnikisht të motivuara. Në këtë drejtim, do të ishte mirë të gjendet një mënyrë që në të ardhmen në proces të përfshihen më shumë gjyqtarë dhe prokurorë vendor në mënyrë që ata më tej të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë të ligjit. Dinamikë e ngjashme do të duhej të merret parasysh edhe në lidhje me prokurorët ndërkombëtar dhe vendor të punojnë së bashku në rastet e krimeve të luftës në mënyrë që të ngjajë bartja e njohurive dhe të fitohet përvoja.⁹⁵

Perceptimi i anshmërisë

Një ndër arsyt kryesore të përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në sistemin gjyqësor vendor të Kosovës, ishte shqetësimi lidhur me anshmërinë brenda gjyqësorit vendor, veçanërisht në rastet e krimeve të luftës dhe atyre etnikisht të motivuara. Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës është thelbësore për një gjykim të drejtë.⁹⁶ Veç kësaj, pavarësia dhe paanshmëria kanë një përbërës si objektiv ashtu edhe subjektiv. Kjo është, jo vetëm që drejtësia duhet të ndodh, por ajo duhet të shihet se po ndodh. Një “arsye legjitime lidhur me frikën e mungesës së paanshmërisë” të një gjyqtari mjafton për të kërkuar heqjen e tij/saj nga rasti.⁹⁷ Perceptimi i disave ka

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ Neni 6(1), KEDNJ.

⁹⁷ *Hauschildt kundër Danimarkës*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 24 majit 1989, paragrafi 48. Në jurisprudencë të mëvonshme, gjykata elaboroi: “[m]e çfarë kemi të bëjmë është besimi të cilin gjykata në një shoqëri demokratike duhet të ja inspirojë publikut, dhe, mbi të gjitha, kur kemi të

qenë se gjyqtarët vendor do të mbanin anë duke vendosur lidhur me rastet e krimeve të luftës për shkak të përvojës së tyre personale gjatë konfliktit. Përpos ndonjë ndjenje personale është gjithashtu edhe çështja e presionit shoqëror që të përkrahet shkak i komunitetit të tyre përkatës. Për shembull, nëse kërkohet nga një gjyqtar i një etniteti që të shqyrtojë një rast ku i pandehuri i përkiste etnitetit tjetër të përfshirë në konflikt, gjyqtari do të mund të mbajë anë të fortë për ta shpallur të pandehurin fajtor. Nga ana tjetër, nëse po ky i njëjti gjyqtar do të shqyrtonte rastin ku i pandehuri i përket etnitetit së tij/saj, atëherë do të mund të kishte presion të madh që ta lirojë të pandehurin, si përkrahës i shkakut. Kjo është tipike në një mjedis pas konfliktit ku janë të përfshirë etnitet të ndryshme. Të pandehurit nuk do të kenë gjykim të drejtë nën rrethana të tilla. Kjo përkrah idenë, se së paku për një të ardhme të paraparë, gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar duhet të mbesin në Kosovë për të punuar në këto raste.⁹⁸

Kërcënimet ndaj gjyqësorit

Një tjetër çështje është ajo e mbrojtjes së gjyqtarëve vendor në rastet e krimeve të luftës. OSBE më parë ka raportuar në lidhje me mungesën e aranzhimeve për mbrojtjen e akterëve të sistemit gjyqësor vendor.⁹⁹ Një numër shqetësimesh ishin ngritur nga anëtarë të gjyqësorit vendor lidhur me kërcënime dhune ndaj tyre dhe familjeve të tyre derisa ishin pjesë të kolegjeve të tilla. Këto mund të manifestohen në formë të presionit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për qëllime frikësimi, si nga publiku i gjerë ose nga zyrtarë tjerë që përdorin presion politik. Gjyqtarët vendor nuk kanë nivelin e njëjtë të mbrojtjes së afërt siç e kanë gjyqtarët ndërkombëtar. Si të tillë, disa anëtarë nga gjyqësori vendor kanë pranuar se janë falënderues që të mos shërbejnë pranë kolegjeve në rastet e krimeve të luftës për shkak të këtij kërcënimi. Kjo është një arsye tjetër që të vazhdohet praktika e caktimit të gjyqtarëve ndërkombëtar për rastet e krimeve të luftës. Është e arsyeshme që të fillohet identifikimi i resurseve të nevojshme për të ndihmuar sigurimin e mbrojtjes për gjyqtarët vendor, dhe në disa raste madje edhe për familjet e tyre, pasi që ata tashmë veçse janë në përbërje të kolegjeve në raste të krimeve të luftës.¹⁰⁰

UNMIK-u ka pasur një “Komision për Vlerësim të Kërcënimit”, i cili në mënyrë individuale vlerësonte kërcënimet ose kërcënimet e perceptuara kundër anëtarëve të gjyqësorit dhe prokurorisë. Nëse komisioni gjente se ekziston rreziku i mjaftueshëm, mbrojtja e afërt i caktohej gjyqtarit ose prokurorit. Megjithatë, kjo ishte e zbatueshme vetëm për anëtarët ndërkombëtar dhe linte gjyqtarët dhe prokurorët vendor me mundësinë e vetme që ta informojnë SHPK-në lidhur me shqetësimet e tyre, që kryesisht nuk rezultonte në nivel të ngritur të mbrojtjes. EULEX-i ka të vendosur një mekanizëm të ngjashëm për të përcaktuar nivelet e kërcënimeve ndaj ndonjërit prej gjyqtarëve dhe prokurorëve të vet ndërkombëtar. Gjyqtarët dhe prokurorët vendor që trajtojnë rastet e krimeve të luftës do të kenë nevojë për mbrojtje.

bëjmë me procedura penale, të akuzuarit.” *Fey kundër Austrisë*, GjEDNj, aktgjykimi i 24 shkurtit 1993, paragrafi 30.

⁹⁸ Shih Pjesën 6, *Shqyrtimi i parë i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë*, 1shkurt 2000 – 31 korrik 2000.

⁹⁹ Shqyrtimi i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale “*Mbrojtja e Dëshmitarëve në Sistemin e Drejtësisë Penale*”, mars 2002- prill 2003, faqe 12.

¹⁰⁰ Në rastin grupi i Llapit të përmendur më lartë, gjyqtari vendor i kolegjit deklaroi publikisht, se si distancohej nga aktgjykimi përfundimtar, që e kishin kërcënuar dhe frikësuar. Kjo ka mund të jetë motivi i tij për kundërshtimin e aktgjykimit, që natyrisht është në kundërshtim me kodin gjyqësor të sjelljes.

Mbrojtja e dëshmitarëve

Një shqetësim tjetër i ndërlidhur është nevoja për mbrojtje të dëshmitarëve. Kjo çështje ka ulur ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës ndoshta më shumë se çdo çështje tjetër. Kjo temë ishte adresuar për së gjëri në raste tjera, siç është raporti i përbashkët vlerësues i Departamentit të Drejtësisë së SHBA-ve dhe OSBE-së i publikuar në nëntor 2007, kështu që këtu do të adresohet shkurtimisht.¹⁰¹ Megjithatë, pesha e madhe e problemit dhe sfida e madhe në zgjidhjen e tij nuk mund të nënvlerësohen. Dëshmitarët, të cilët në shumë raste janë qenësor që ti lidhin të pandehurit me krime për të cilat ata akuzohen, bëhen edhe më ngurrues për të dëshmuar para institucioneve, qoftë para policisë, prokurorëve dhe/ose gjyqtarëve në gjykata. Kosova ka një strukturë ngushtë të thurur të familjeve të gjëra, që i bën dëshmitarët edhe më të ndjeshëm ndaj kërcënimeve dhe frikësimeve. Po ashtu Kosova është relativisht e vogël, kështu që njerëzit e njohin njëri tjetrin në tërë shoqërinë. Andaj, edhe po që se dëshmitarët do të ishin të pajtimit të dëshmojnë përballë kërcënimeve të sigurisë personale, ata prapë mund të dorëzohen përballë kërcënimeve ndaj anëtarëve të familjes.

GJNPJ-ja ka punuar që të trajtojë çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve në rastet e tyre që kanë dal nga ngjarjet e konfliktit në Kosovë. Megjithatë, edhe me gjithë resurset dhe ekspertizat e tyre ata u përballën me vështirësi të mëdha në këtë fushë po ashtu, siç ishte dëshmuar me komentet në aktgjykimin Haradinaj *et alia*.¹⁰² Në fakt, ky është fokusi i ankesës të rastit të prokurorisë. Për t'i adresuar këto probleme UNMIK-u themeloi Njësitin për Mbrojtje të Dëshmitarëve dhe Viktimave në vitin 2001, që tregoi efikasitet të kufizuar, në masë të madhe për shkak të fushëveprimit të gjerë dhe ndërlikueshmërisë së problemit. Përderisa shumë përpjekje janë bërë që kjo çështje të trajtohet, ajo akoma qëndron. EULEX-i ka vazhduar punën e mbrojtjes së dëshmitarëve me Njësitin e vet për Mbrojtje të Dëshmitarëve.

Një projekt ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve është duke u punuar që disa vite, mirëpo ende nuk është miratuar. Versioni përfundimtar duhet të përmbajë masat për adresimin e çështjeve të mësipërme. Megjithatë, ligji është vetëm një hap në procedurë. Implementimi i tij do të përcaktojë efikasitetin e mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë.

Për më tepër, ri-vendosja e dëshmitarëve është një pjesë jetike e programit të përgjithshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve. Është gjithashtu edhe më i vështiri për tu zbatuar. Shumë vende ngurrojnë të pranojnë dëshmitarë nga rajonet e dala nga konflikti. Dëshmitarët nga Kosova nuk janë ndonjë përjashtim. Megjithatë, në një mjedis aq të mbyllur, ndonjëherë e vetmja mënyrë që të garantohet siguria e dëshmitarëve dhe familjeve të tyre është që të zhvendosen në jashtë Kosovës. Andaj, ato autoritete jashtë Kosovës që kanë interes ta shohin drejtësinë e vendosur duhet të

¹⁰¹ Raportet e OSBE-së. *Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale* (mars 2002-prill 2003). E qasur me 23 prill 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2003/05/859_sq.pdf dhe *Mbrojtja dhe Siguria e Dëshmitarëve në Kosovë: Vlerësim dhe Rekomandime*, (nëntor 2007). E qasur me 23 prill 2010 në http://www.osce.org/documents/cio/2007/11/27752_sq.pdf.

¹⁰² Shih Rastin Nr. IT-04-84-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, *Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj*, 03 prill 2008, paragrafët 22-28. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/080403.pdf>.

jenë më shumë të gatshëm të pranojnë ata që kanë nevojë për zhvendosje në mënyrë që të bëjnë të mundshëm gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Mbështetja e dëshmitarëve është një aspekt shtesë që duhet më mirë të trajtohet. Gjykimi i rasteve të krimeve të luftës bie në barrë të gjithë të përfshirëve, veçanërisht të viktimave dhe dëshmitarëve. Andaj, përkrahja është e nevojshme në mënyrë që të shmanget ri-traumatizimi i viktimave. Shërbimet psikologjike janë të nevojshme për viktimat, dëshmitarët dhe familjet e tyre të cilët janë duke u ballafaquar me vështirësi emocionale derisa i ri-përfjetojnë ngjarjet e konfliktit. Këto shërbime mund të nevojiten gjatë gjitha fazave të gjyimit. Përkrahja është po ashtu e nevojshme për çështje praktike siç është ofrimi i transportit të sigurt deri në dhe nga të gjitha procedurat gjyqësore në të cilat kërkohet paraqitja e dëshmitarëve. Shumë dëshmitarë nuk kanë mjete të vijnë në gjykatën ku shqyrtohet rasti, sepse jetojnë diku tjetër. Mbajtja e dëshmitarëve në një vend të sigurt gjatë procedurës së gjyimit është po ashtu me rëndësi. Në shumë raste dëshmitarët mbahen në korridoret e gjykatave duke pritur radhën e tyre për të dëshmuar, përballë me kushërinjtë, shokët dhe bashkëpunëtorët e të pandehurit në gjykim. Veç kësaj, kur gjykata bën pauzë gjatë ditës së gjyimit, të pandehurit shumë herë i shohin dëshmitarët në vende të zakonshme brenda ndërtesës së gjykatës, duke ju ofruar mundësia për kërcënim.

Oda e veçantë për rastet e krimeve të luftës

Çështjet lidhur me personel të mjaftueshëm gjyqësor, kompetencë të akterëve gjyqësor, anshmëri, mbrojtje të gjyqtarëve, prokurorëve, viktimave dhe dëshmitarëve, të gjithat mund të adresohen me formimin e një gjykate ose ode speciale për shqyrtimin e rasteve të krimeve të luftës. Kjo fushë e ligjit kërkon një nivel të lartë të kuptimit të shumëllojshmërisë së vet kështu që trajnim dhe përvojë e specializuar duhet të kërkohet për ata persona të caktuar për të ndjekur, mbrojtur dhe gjykuar rastet e tilla. Për më tepër, këto raste normalisht kërkojnë për mbrojtje të shtuar të gjyqtarëve, prokurorëve, viktimave dhe dëshmitarëve. Shumë herë, dëshmitarëve u duhet përkrahje e veçantë. Krijimi i një gjykate/ode speciale do t'i lejonte gjykatës të përqendrohet ekskluzivisht në raste të krimeve të luftës, duke ofruar kështu vendosjen në prioritetin e duhur të këtyre rasteve. Që kjo të funksionojë, resurse adekuate janë të nevojshme, dhe ato të cilat nuk kanë mundur të drejtohen në raste tjera, pavarësisht sa urgjente të jenë. Në të kundërtën asnjë nga përfitimet e sipërpërmendura nuk do të mund të realizohej në situatën e tanishme.

Disa kanë propozuar se një gjykatë/odë e tillë do të duhej të trajtojë gjithashtu edhe vepra tjera serioze me dinamikë të ngjashme, siç janë rastet e krimit të organizuar, ku do të kërkohet gjithashtu mbrojtje e shtuar. Disa tjerë kanë argumentuar kundër një gjykate/ode të tillë si e panevojshme dhe kanë shprehur shqetësimin se kjo do të mund të shtjerr resurset nga gjykatat e rregullta të cilat janë të mbi-ngarkuara. Veç kësaj, disa thonë se kanë kaluar dhjetë vite që prej përfundimit të konfliktit dhe shumë kohë ka kaluar për të justifikuar themelimin e një gjykate/ode të re.

OSBE kupton shqetësimet lidhur me këtë debat. Megjithatë, beson se është i nevojshme themelimi i një ode të veçantë për të trajtuar rastet serioze siç janë rastet e krimeve të luftës. Si alternativë një sektor i veçantë për raste të krimeve të luftës do të mund të krijohej nga EULEX-i si pjesë e rolit të tij të jashtëzakonshëm në sektorin e drejtësisë. Edhe pse EULEX-i aktualisht ka dy prokurorë ndërkombëtar të caktuar për

raste të krimeve të luftës.¹⁰³ problemi ka qenë, dhe ende është, që nga personeli gjyqësor kërkohet në mënyrë rutinore që të punojë në raste tjera. Kjo ka efektin e dëmtimit të çfarëdo përpjekjeje për të vënë prioritet në rastet e krimeve të luftës. Veç kësaj, çështja e kompetencës së mjaftueshme të akterëve të përfshirë në raste të tilla mund më mirë të adresohet nëse akterët janë të përqendruar vetëm në këtë çështje në vend se kjo të jetë vetëm një nga shumë raste. Së fundmi, duke i përqendruar resurset në një odë të specializuar do të sillte edhe përfitim lidhur me ofrimin më të mirë dhe më të specializuar të mbrojtjes për gjyqtarë, prokurorë, viktima dhe dëshmitarë. Derisa argumenti për kohën e kaluar nga konflikti ngrit një çështje interesante, rasti i themelimit të Odës për Krime të Luftës të Gjykatës Shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës në janar të vitit 2005 duhet të merret parasysh. Është themeluar dhjetë vite pas përfundimit të konfliktit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe, sepse besohet se ka pasur ende baza të mjaftueshme për ekzistimin e saj.

Menaxhimi me barrën e lëndëve të krimeve të luftës

Ngarkesa e përgjithshme me raste të krimeve të luftës që janë identifikuar është mjaft e madhe. Raporti i 6 prillit 2010 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara thotë që “[N]jësi për Hetimin e Krimeve të Luftës pranë EULEX-it ka përfunduar një raport gjithëpërfshirës të 888 rasteve për të cilat Prokurori nga Prokuroria Speciale e Kosovës ka parashtruar kërkesë për hetime në vitin 2009”.¹⁰⁴ Këto domosdoshmëri do të përfshijnë të pandehur të shumëfishtë dhe/ose aktakuza me pika të shumëfishta, duke e bërë shumë të lartë numrin e incidenteve dhe të dyshuarve të hetuar. Kështu, hetuesit dhe prokuroria e EULEX-it do të duhen të përfundojnë procedurën e planifikimit, seleksionimit dhe vënien në prioritet të rasteve të krimeve të luftës në mënyrë që të kenë një qasje më të qëndrueshme lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Ky proces është i domosdoshëm për ndjekjen e rasteve me prioritet dhe po ashtu do të çojë në një dorëzim më të mirë të këtyre rasteve tek akterët vendor në të ardhmen. Planifikimi është gjithashtu i mirë për qëllime historike, arsimore dhe për pajtim, si dhe për ngritje të vetëdijesimit të publikut atëherë kur të bëhet e dhënë publike. Përvoja, mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira nga GJNPJ-ja dhe të tjerëve që punojnë në rajon do të ishin të dobishme për këto qëllime.

Informimi i publikut lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës

Informimi është një përbërës i domosdoshëm por shpesh i anashkaluar në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Informimi nuk është thjeshtë lëshimi i një deklarate për shtyp lidhur me një aktgjykim në një rast të veçantë. Shkon shumë më larg, pasi që ka të bëjë me hapa afirmativ të mara për të informuar dhe arsimuar publikun lidhur me atë se çfarë po ndodh në përgjithësi me rastet e krimeve të luftës përveç shpalljes së rezultateve në raste specifike. Kjo shërben për të çuar përpara procesin kur mbërthehet me atë se çfarë ka ndodhur gjatë konfliktit, të lejojë njerëzit të mësojnë se çfarë është duke u ndërmarr në lidhje me këtë, dhe kështu të mundet perceptimi se kriminelët e luftës kanë vepruar pa u ndëshkuar, që rrjedhimisht mund të ndihmojë drejt pajtimit në mes të komuniteteve.

¹⁰³ Intervistë me një zyrtar nga EULEX-i, 29 prill 2010.

¹⁰⁴ *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/2009/169, 6 prill 2010, Shtojca I, pika 2. Policia. E qasur me 25 maj 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/sgrep10.htm> e më pas në raportin i 6 prillit 2010.

Nuk ka pasur qasje adekuate në lidhje me atë se çfarë ka ndodhur me rastet e GJNPJ-së të ndërlydhura me konfliktin në Kosovë. GJNPJ-ja themeloi një Zyrë për Informim në Prishtinë/Priştina¹⁰⁵ në shkurt të vitit 2001 e cila vazhdon të operojë. Në vitin 2009 zyra vizitoi shkollat e mesme vendore për ti arsimuar nxënësit lidhur me krime të luftës. Në të kaluarën, studentët nga Kosova kanë shkuar për vizitë në GJNPJ në Hagë.

Nevojat tjera

Ka një numër të resurseve praktike të cilat ende duhen për të ndihmuar edhe më tej sektorin e drejtësisë në Kosovë. Për qëllime transparence aktgjykimet përfundimtare të rasteve të krimeve të luftës duhet të jenë në dispozicion në internet. Kjo është gjithashtu e dobishme për të gjithë ata të cilët punojnë në raste të tilla për të pasur një kuptim më të mirë të çështjeve themelore ligjore. Veç kësaj, komentaret dhe të gjitha materialet përkatëse të GJNPJ-së duhet të përkthehen në gjuhët e rajonit dhe të jenë të qasshme në internet. Megjithatë, jo të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë kanë lidhje interneti apo kompjuterë. Kjo duhet të konsiderohet si çështje urgjente. Së fundmi, Gjykata Supreme ka nevojë për një sallë më të madhe gjykimi për të akomoduar numrin e personave të domosdoshëm për raste të ndërlykuara me palë të shumëfishta.

IV. KONKLUZION

Më shumë se dhjetë vite pas përfundimit të konfliktit, sistemi gjyqësor në Kosovë vazhdon të dështojë që në mënyrë adekuate të vë në prioritet gjykimin e rasteve të krimeve të luftës. Ky dështim bie në kundërshtim me pritjet e publikut dhe interesit të drejtësisë dhe pajtimit. Rastet e krimeve të luftës, për shkak të natyrës, peshës dhe rëndësisë së tyre lidhur me procesin e pajtimit, nuk ishin marrë parasysh në mënyrë të duhur nga institucionet gjyqësore. Ndarja me kohë e drejtësisë në rastet e krimeve të luftës është e një rëndësie të veçantë për shkak se zbeh perceptimin e veprimit pa u ndëshkuar në këto raste. Ligji ndërkombëtar definojnë veprimin pa u ndëshkuar si “dështim [...] në përmbushjen [...] e obligimeve për të hetuar shkeljet; për të marr masa të duhura ndaj kryesve të veprave, veçanërisht në fushën e drejtësisë, duke siguruar që të dyshuarit për përgjegjësi penale të ndiqen, gjykohen dhe të dënohen në mënyrë adekuate; për t’i ofruar viktimave mjete efektive dhe për të siguruar që të marrin kompensim për lëndimet e vuajtura; për të siguruar të drejtën e pamohueshme për të ditur të vërtetën lidhur me shkeljet; dhe për të marr hapat e tjerë të domosdoshëm për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve”¹⁰⁶

OSBE gjithashtu nënvizon me shqetësim se për një numër relativisht të vogël të rasteve të krimeve të luftës që kanë arritur të hyjnë në sistem gjyqësor, ka pasur vonesa të përsëritura në secilën fazë të procedurave penale. Një faktor i rëndësishëm që u ka kontribuar këtyre vonesave është se shumë të dyshuar në këto raste kanë ikur nga juridiksioni dhe janë të pa-qasshëm për institucionet gjyqësore të Kosovës.

¹⁰⁵ Shih deklaratën për shtyp të GJNPJ-së, LM/P.I.S./579e, 23 mars 2001. E qasur me 4 maj 2010 në <http://www/icty.org/sid/8001> (faqja në dispozicion vetëm në gjuhën angleze).

¹⁰⁶ Parimi 1 i *Parimeve të Azhurnuara mbi mbrojtjen dhe veprimin për të mundur veprimin pa u ndëshkuar* të KB-ve, që u rekomandua nga Komisioni i mëhershëm i KB-ve për të Drejtat e Njeriut në Rezolutën e vet 2005/81. Parimet e azhurnuara ishin publikuar në Dokumentin e KB-ve E/CN.4/2005/102/Add.1.

Shumë raste janë pezulluar për shkak të mungesës së të pandehurve në procedurë penale.¹⁰⁷ Andaj, nevojitet një bashkëpunim i shtuar gjyqësor rajonal për të adresuar këtë shqetësim në mënyrë adekuate.

Një tjetër çështje që pengon zgjidhjen e rasteve të krimeve të luftës është mungesa e një programi për mbrojtje të dëshmitarëve. Mungesa e një programi të tillë është një pengesë e madhe në mbledhjen e dëshmimeve përkatëse. OSBE mirëpret përpjekjet e institucioneve për të adresuar këtë situatë në formë të një projekt-ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve.¹⁰⁸ Megjithatë, OSBE kërkon nga institucionet që të ngritin besimin e publikut në aftësinë e vet për ofrimin e mbrojtjes adekuate për dëshmitarët, veçanërisht në rastet e krimeve të luftës, duke miratuar dhe zbatuar projekt-ligjin.

Sa i përket themelimit të një ode të specializuar të gjykatës për të trajtuar veprat serioze penale siç janë rastet e krimeve të luftës, OSBE mirëpret përfshirjen e dispozitave mbi departamentin e veçantë për krime serioze¹⁰⁹ në projekt-ligjin mbi gjykatat¹¹⁰ që pritet të shpallet dhe miratohet gjatë vitit 2010.

Ndjekja dhe gjykimi i rasteve të krimeve të luftës është një funksion i rëndësishëm i sistemit gjyqësor në shoqëri të dala nga konfliktet. Vënia në prioritet e rasteve të krimeve të luftës nga sistemi gjyqësor i Kosovës është i rëndësishëm për të “[...] promovuar mundësitë për paqe, pajtim dhe demokraci”¹¹¹, vendosur përgjegjësinë dhe për të siguruar drejtësi për viktimat dhe publik.

V. REKOMANDIME

Në drejtim të asaj që u tha më lartë, OSBE ofron rekomandimet në vijim.

Për institucionet e Kosovës:

- Gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës do të duhej të sigurojnë që rastet e mbetura të krimeve të luftës të procedohen nga sistemi gjyqësor si raste me prioritet.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) do të duhej të ofrojë trajnime afat-gjata të specializuara për krime të luftës, testim dhe certifikime të gjyqtarëve të cilët janë të caktuar të trajtojnë rastet e krimeve të luftës.
- Oda e Avokatëve të Kosovës do të duhej të ndihmojë në organizimin e trajnimeve për avokatët mbrojtës në rastet e krimeve të luftës. Do të duhej të

¹⁰⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/1 *Mbi Ndalimin e Gjykimeve në Mungesë për Shkelje Serioze të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar, e miratuar më 12 janar 2001.*

¹⁰⁸ Përpilimi i ligjit mbi mbrojtjen e dëshmitarëve është paraparë me Strategjinë Legjislative të vitit 2010.

¹⁰⁹ Neni 14 dhe Neni 19 i projekt-ligjit mbi gjykatat.

¹¹⁰ Përpilimi i ligjit mbi gjykatat është i paraparë me Strategjinë Legjislative të vitit 2010. Leximi i parë i projekt-ligjit mbi gjykatat nga Kuvendi i Kosovës ndodhi më 15 prill 2010.

¹¹¹ Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Tranzicion, *Çfarë është Drejtësia në Tranzicion*, dhjetor 2008 <http://www.ictj.org/en/tj/>.

punojë bashkë me organizata ndërkombëtare dhe donatorë për të ndihmuar rreth sigurimit të një angazhimi afat-gjatë për të financuar trajnime të tilla.

- Policia e Kosovës do të duhej të zgjerojë programin e trajnimeve të specializuara që i ofrohen policëve të cilët janë të caktuar të punojnë në njësitin hetimor për krime të luftës. Ata do të duhej të punojnë për së afërmi me njësitin hetimor për krime të luftës pranë EULEX-it duke parashikuar dorëzimin në të ardhmen, të hetimeve në rastet e krimeve të luftës. Policia e Kosovës po ashtu do të duhej të ofrojë trajnime të specializuara për policët lidhur me atë se si ti mbrojnë dëshmitarët dhe familjet e dëshmitarëve që janë të përfshirë në rastet e krimeve të luftës.

Për komunitetin ndërkombëtar dhe institucionet:

- Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it do të duhej të sigurojnë që rastet e mbetura të krimeve të luftës të procedohen nga sistemi gjyqësor si raste me prioritet.
- Për shkak të ndërlikueshmërisë së çështjes lëndore, trajnim i specializuar për raste të krimeve të luftës do të duhej të ofrohet po ashtu edhe për gjyqtarët ndërkombëtar që janë të caktuar për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës të cilët nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme në këtë fushë të ligjit.
- Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (GJNPJ) do të duhej të përmbush angazhimin e vet për ti ofruar zyrave të EULEX-it të hetimit dhe prokurorisë qasje të drejtpërdrejtë dhe të sigurt në dëshmi të mbledhura gjatë hetimit të krimeve të pandehura të luftës në Kosovë. GJNPJ do të duhej të vazhdojë të përkthejë plotësisht të gjitha materialet përkatëse të gjeneruara nga hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet e rasteve të krimeve të luftës në gjuhët përkatëse zyrtare në Kosovë.
- Komuniteti donator ndërkombëtar dhe institucionet inkurajohen që të ofrojnë mbështetje në fushat vijuese: në lidhje me IGJK-në, të financojnë trajnimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve për rastet e krimeve të luftës; në lidhje me Odën e Avokatëve, të financojnë trajnimet për avokatët mbrojtës në rastet e krimeve të luftës; në lidhje me organet përkatëse dhe ndërkombëtare në Kosovë, të financojnë sistemin për mbrojtje të dëshmitarëve. Që sistemi për mbrojtje të dëshmitarëve të ketë sukses, do të jetë e nevojshme gatishmëria për të pranuar viktimat, dëshmitarët dhe familjet e tyre në vende jashtë Kosovës për periudha të gjata kohore.